

UDHËZIM

“PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- 1– *Objekti i Ligjit*
- 2 – *Përkufizime*
- 3 – *Burimi i të ardhurave*
- 4 – *Selia e përhershme*
- 5 – *Fusha e zbatimit*
- 6 – *Viti tatimor*

TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

- 7 – *Tatimpaguesi i Tatimit mbi të Ardhurat Personale*
- 8 – *Rezidenca e personave fizikë*
- 9 – *Dokumentacioni*
- 10 – *Të ardhurat personale të tatueshme*
- 11 – *Kategoritë e të ardhurave personale që nuk janë subjekt i Tatimit mbi të Ardhurat Personale*
- 12 – *Të ardhurat nga Punësimi*
- 13 – *Të Ardhurat nga Biznesi*
- 14 – *Regjimi i veçantë për individët tregtarë dhe të vetëpunësuar*
- 15 – *Të Ardhurat nga Investimet*
- 16 – *Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e letrave me vlerë dhe mjeve virtuale*
- 17 – *Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme*
- 18 – *Të ardhurat vjetore të tatueshme nga investimi*
- 19 – *Rregullat për entitetet e huaja të kontrolluara*
- 20 – *Tatimi i pensioneve private*

- 21 – *Baza Tatimore Vjetore*
- 22 – *Zbritjet nga Baza Tatimore*
- 23 – *Kerkesa per zbritje*
- 24 – *Norma tatimore*
- 25 – *Kreditimi i tatimit të huaj*
- 26 – *Llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat personale*

TATIMI MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS

- 27 – *Tatimpaguesit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave*
- 28 – *Rezidenca*
- 29 – *Përjashtimi në Pjesëmarrje*
- 30 – *Rregullat e Kufizimit të Interesit*
- 31 – *Rezerva e borxhit të keq për institucionet financiare*
- 32 - 39 – *Udhëzim specifik i Ministrisë së Financave në lidhje me taksimin ndërkombëtar*
- 40 – *Të ardhurat dhe llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat e korporatave*
- 41 – *Norma tatimore*
- 42 – *Kreditimi i tatimit të huaj për tatimin mbi të ardhurat nga korporatat*

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI PËRCAKTIMIN E FITIMIT

- 43 – *Fitimi i Tatueshëm*
- 44 – *Parimi i tregut*
- 45 – *Kontratat afatgjata*
- 46 – *Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit*
- 47 – *Tatimi i llogaritur për transferimin e aktiveve të biznesit*
- 48 – *Shpenzimet e Zbritshme*
- 49 – *Shpenzimet të Zbritshme për Tokën që Shkëmbehet për Ndërtim*
- 50 – *Shpenzimet jo të Zbritshme dhe kufizimi i Zbritjes*
- 51 – *Amortizimi*

52 – *Vlerësimi i inventarit*

53 – *Zbritjet e Borxhit të Keq*

54 – *Mbartja e Humbjeve*

55 – *Tatimi i ndryshimit të pronësisë për sektorë të veçantë*

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË MBAJTJES SË TATIMIT NË BURIM

56 – *Agjenti i mbajtjes së Tatimit në Burim*

57 – *Deklarata e Tatimit të Mbajtur në Burim*

58 – *Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim*

59 – *Norma e mbajtjes së tatimit në burim*

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI TATIMIN E TRASHËGIMISË, DHURATAVE DHE FITIMEVE NGA LOJRAT E FATIT

60 – *Tatimi i trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojrat e fatit*

DISPOZITA TË MBLEDHJES SË TATIMIT

61 – *Deklarata Tatimore Vjetore*

62 – *Kërkesat për Dokumentacion*

63 – *Parapagimet*

64 – *Deklarata plotësuese tatimore*

65 – *Agjenti Tatimor i Listëpagesës*

66 – *Deklarata mbi Statusin Personal*

67 – *Deklarata vjetore e të ardhurave personale*

68 – *Deklarimi dhe pagesa nga entitete jorezidentë specifike*

69 – *Lehtësitë tatimore*

UDHËZIM I PËRGJITHSHEM

Nr. __, datë _/_/_

PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit ____ të Ligjit Nr. __, datë _/_/_ , “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, Ministri i Financave,

UDHËZON:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Në këtë Udhëzim të Përgjithshëm përcaktohen kriteret dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të Ligjit nr. __. Date __. __. ____ “Për Tatimin mbi të Ardhurat”

1. Objekti i Ligjit

1.1 Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat” përcakton skemën e tatimit të të ardhurave direkte dhe rregullat që zbatohen në lidhje me këtë skemë nga personat, përfshirë entitetet ligjore, të quajtur edhe “persona juridikë”, si dhe personat fizikë ku përfshihen individët, personat fizikë tregtarë dhe personat fizikë të vetpunësuar.

1.2 Për të gjitha kategoritë e përmendura në paragrafin e mësipërm, Ligji përcakton bazën e tatimit, tarifatatimore, përjashtimet, procedurat dhe afatet e deklarimit dhe pagesës, si dhe çdo procedurë apo detyrim tjetër të nevojshëm për administrimin e detyrimeve tatimore mbi të ardhurat.

1.3 Gjithashtu ky Ligj, përveç të ardhurave nga punësimi, biznesi dhe investimi, mbulon edhe të ardhurat e një natyre tjetër sikurse janë të ardhurat nga trashëgimitë, dhurimet dhe fitimet nga lojrat e fatit.

2. Përkufizimet

2.1 Termat e përdorur në Ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” kanë kuptimin që i është dhënë në këtë Ligj.

2.2 Nëse për ndonjë term të përdorur në këtë ligj, legjislacionet e fushave të tjera kanë kuptim të ndryshëm, për nevoja të interpretimit të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat, do përdoren përkufizimet e bëra në këtë Ligj.

2.3 Për terma të përdorura në Ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” për të cilat nuk është dhënë ndonjë përkufizim, për nevoja interpretimi do përdoren përkufizimet e dhëna për këto terma në legjislacionin e fushave të tjera.

2.4 Termat e përdorur në Ligj dhe që lidhen me terminologjinë e taksimit ndërkombëtar do kenë kuptimin e dhënë në dokumentet e gjithëpranuara ndërkombetare të fushës të botuara nga FMN, OECD, BE.

3. Burimi i të ardhurave

3.1 Në zbatim të parimit të “burimit të të ardhurave”, personat rezidentë shqiptarë qofshin entitete (persona juridikë) apo persona fizikë (individë, të vetpunësuar, tregtarë) paguajnë në Shqipëri tatim për të ardhurat e realizuara brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërkohë, personat jorezidentë shqiptarë qofshin entitete (persona juridikë) apo persona fizikë (individë, të vetpunësuar, tregtarë) paguajnë në Shqipëri tatim vetëm për të ardhurat e realizuara brenda Shqipërisë.

3.2 Në këtë kuptim, nisur nga parimi i burimit të të ardhurave, përcaktimi i llojeve të të ardhurave që mund të realizohen të Shqipëri, dhe që janë objekt i tatimit në Shqipëri, është i rëndësishëm me qëllim planifikimin tatimor nga rezidentët dhe jorezidentët.

3.3 Neni 3 i Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, ka përcaktuar grupet e të ardhurave të cilat rrjedhin/krijohen nga një burim në Republikën e Shqipërisë. Por të ardhurat me burim në Republikën e Shqipërisë, që mund të jenë subjekt i tatimit mbi të ardhurat, nuk kufizohen vetëm në grupin e të ardhurave të listuara në paragrafet “a” deri “o” të këtij neni, pra nuk janë shteruese, por mund të zgjerohen me kategori të tjera të ardhurash me burim në Shqipëri.

3.4 Të ardhurat me burim në Shqipëri mund të identifikohen nisur nga pagesat që bëjnë personat rezidentë tatimorë shqiptarë për persona rezidentë apo jorezidentë tatimorë shqiptarë, pavarësisht nga detyrimi i paguesit të të ardhurave për të mbajtur tatimin në burim apo detyrimin të përfituesit të të ardhurave për të deklaruar të ardhurën e marrë dhe për të paguar detyrimin tatimor në lidhje me këtë të ardhur.

3.5 Të ardhurat e listuar në nenin 3, paragrafet “a” deri “o” janë potencialisht burim për llogaritjen e detyrimit tatimor, ndërkohë që llojet konkrete të të ardhurave të tatueshme sipas kategorive (të ardhura nga punesimi, biznesi, investimi, trashëgimitë, dhurimet, lojrat e fatit) janë përcaktuar në mënyrë eksplicite në nenet, kapitujt dhe pjesët e tjera të Ligjit.

3.6 Paragrafi “f”, i këtij neni sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat për shfrytëzimin e resurseve dhe të mirave natyrore shqiptare, konsiderohen me burim në Shqipëri, janë të tatueshme në Shqipëri dhe do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e tjera nga pasuria e paluajtshme. Këto të drejta në veçanti përfshijnë licencat dhe marrëveshjet që lejojnë nxjerrjen e mineraleve, apo të naftës dhe gazit. Gjithashtu, të ardhurat që sigurohen nga informacionet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me këto të drejta, janë objekt i parashikimeve të paragrafit “f”. Shembull: informacioni sizmik, informacione të tjera teknike dhe analiza që mund të disponohen në lidhje me ekzistencën e burimeve natyrore, p.sh., naftës, gazit, kromit etj., informacione të cilat transferohen te palët e treta.

3.7 Paragrafi “g”, trajton si të ardhura me burim në Shqipëri, të ardhurat nga tjetërsimi i të drejtave objekt i paragrafit “f” të këtij neni. Nën-pika “i” e paragrafit “g” mbulon veçanërisht përfitimet nga shitja e drejtpërdrejtë e të drejtave për të shfrytëzuar burimet natyrore, apo informacionit që u përket të drejtave të tilla. Nën-pika “ii” e paragrafit “g” mbulon shitjet indirekte të aksioneve, të drejtave dhe informacionit të mbuluara nga paragrafi “f”. Ajo

bazohet në parimet e nenit 13(4) të Modelit të tatimit mbi të ardhurat të Konventave të OECD-së dhe OKB-së. Fitimet nga shitja e aksioneve (ose interesave të ngjashëm) që rrjedhin nga pasuria, të drejtat ose informacionet e përmendura në paragrafin “f” trajtohen si me burim në Shqipëri. Megjithatë, duhet që këtyre aksioneve të paktën 50 për qind e vlerës së tyre t’iu burojnë nga pasuria, të drejtat ose informacioni në fjalë. Këto parashikime janë të rëndësishme kryesisht përshit/blerjet e aksioneve ndërmjet personave jorezidentë shqiptarë, në lidhje me pasuri dhe të drejta të vendosura në Shqipëri, ndërkohë që, rezidentët shqiptarë taten për të gjithë të ardhurën në baza mbarëbotërore.

4. Selia e Përhershme

4.1 Parashikimet në lidhje me “selinë e përhershme” ndjekin modelin e parashikimit dhe janë të ngjashme me përcaktimin e këtij koncepti sipas “Modelit të Konventës Tatimore mbi të Ardhurat dhe Kapitalin”, botim i UN dhe OECD së. Kjo për faktin sepse vendi ynë zbaton parimet e këtyre Model Konventash në negociimet me vendet e tjera, në lidhje me Marrëveshjet bilaterale për eliminimin e tatimit të dyfishtë.

4.2 Saktësia në përkufizimin e konceptit të “selisë së përhershme” është e rëndësishme, pasi përcakton të drejtën e Shqipërisë për të tatuar fitimet me burim në Shqipëri të një sipërmarrje të një shteti tjetër.

5. Fusha e zbatimit

5.1 Në përcaktimin e detyrimit tatimor të personave rezidentë shqiptarë, qofshin këta persona fizikë apo entitete, zbatohet parimi i tatimit të të ardhurave mbarëbotërore të tyre, pra i të ardhurave të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe atyre të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, por duke kredituar tatimin e huaj të paguar, deri në masën e detyrimit të pagueshëm në Shqipëri.

5.2 Si parim i përgjithshëm, në përcaktimin e detyrimit tatimor të personave jorezidentë shqiptarë, qofshin këta persona fizikë apo entitete, zbatohet parimi i tatimit të të ardhurave me burim në Shqipëri, por edhe i të ardhurave të tyre të tatueshme në mbarë botën që i atribuohen një selie të përhershme në Shqipëri, apo edhe të ardhurave të tyre të tatueshme nga të gjitha burimet por që kanë një burim në Shqipëri, sipas nenit 3 “Burimi i të ardhurave” në një vit të caktuar tatimor.

5.3 Ndërkohë, në zbatim të marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka nënshkruar me vendet e tjera dhe të cilat janë në fuqi, përcaktohen të ardhurat dhe normat e tatimit në lidhje me pjesën e tatimit që duhet të paguhet në Shqipëri, si dhe metodat e eliminimit të tatimit të dyfishtë nëpërmjet mekanizmit të përjashtimit të tatimit në burim apo kreditimit të tatimit të paguar në Shqipëri.

6. Viti Tatimor

6.1 Për efekte të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore, viti tatimor është i njëjtë me vitin kalendarik dhe fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

KREU 2 TATIMI MBI TË ARDHURAT PERSONALE

7. Tatimpaguesi i Tatimit mbi të Ardhurat Personale

7.1 Personat fizikë ku përfshihen individët dhe personat fizikë tregtarë, apo të vetpunësuar, deklarojnë dhe paguajnë “Tatim mbi të ardhurat personale”.

7.2 Tatimi mbi të ardhurat personale përfshin:

7.2.1 Tatimin mbi të ardhurat nga punësimi të individëve

7.2.2 Tatimin mbi të ardhurat nga biznesi i individëve tregtarëve dhe të vetpunësuar

7.2.3 Tatimin mbi të ardhurat nga investimi

7.3 Personat fizikë janë gjithashtu subjekt i tatimit mbi të ardhurat nga dhuratat, trashëgimia dhe lojrat e fatit, por ato nuk kategorizohen në grupin e të ardhurave personale sipas paragrafit 7.2 më sipër.

8. Rezidenca e personave fizikë

8.1 Përcaktimi nëse një person fizik (individ, tregtar apo i vetpunësuar) plotëson kushtet e rezidentit tatimor në Republikën e Shqipërisë, është i rëndësishëm për të llogaritur detyrimet e tij tatimore mbi baza mbarëbotërore, pra për të ardhurat e realizuara brenda Shqipërisë dhe jashtë saj.

8.2 Një person fizik, konsiderohet resident tatimor shqiptar, nëse plotëson edhe vetëm një nga kushtet e listuara në shkronjat “a” deri “e” të nenit 8 të Ligjit.

8.3 Ka një vendbanim të qëndrueshëm nënkupton se ka një banesë në pronësi, të dhuruar, të trashëguar, me qera etj, në të cilën jeton.

8.4 Në shkronjën b, përcakohet si kriter periudha kohore minimalisht 183 ditë në total, që një tatimpagues i të ardhurave personale duhet të përmbushë brenda një periudhe tatimore, në Republikën e Shqipërisë. P.sh nëse një individ vjen në shqipëri në datën 30 nëntor të vitit 2022 dhe qëndron deri në 10 qershor të vitit 2023 ai do të konsiderohet resident në Shqipëri pasi brenda një periudhe 12 mujore ka shpenzuar më shumë se 183 ditë në Shqipëri.

8.5 Ka qendrën e interesave jetike në Republikën e Shqipërisë, nënkupton lidhje të rëndësishme personale në Shqipëri (ka familjen, femijët e mitur, bashkëshortin/bashkeshorten, bashkëjetuesin/bashkejetuesen) apo edhe lidhje ekonomike në Shqipëri (ka biznese, menaxhon pasuri, ka investime etj të kesaj natyre).

9. Dokumentacioni

9.1 Tatimpaguesit e tatimit mbi të ardhurat personale mbajnë dokumentacionin dhe të dhënat sipas kërkesave të këtij Ligji. Ata mbajnë gjithashtu dokumentacion dhe të dhëna në përputhje me legjislacionin e kontabilitetit (Ligji “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare) në masën, dokumentacionin dhe të dhënat e kërkuara të përcaktuara në atë legjislacion.

9.2 Tatimpaguesit të cilët dorezojnë Deklaratën e të ardhurave, duhet të justifikojnë cdo të ardhur të deklaruar me dokumentacionin përkatës .

9.3 Personat fizikë të vetpunësuar dhe tregtarët, për të cilët, Ligji “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” nuk përcakton detyrime për mbajtjen e kontabilitetit, janë të detyruar të regjistrojnë të dhënat e veprimtarisë së tij në:

9.3.1 regjistrin e të ardhurave, për të ardhurat ditore që realizojnë;

9.3.2 regjistrin e shpenzimeve, për cdo faturë elektronike shpenzimi që marrin;

9.3.3 kërkesat e arkëtueshme për shitje mallrash dhe shërbimesh me pagesë të mëvonshme dhe detyrimet e pagueshme apo borxhet për llogari të mallrave apo shërbimeve të blera.

Struktura e dokumentacionit të detyrueshëm sa më lart është sipas Aneksit 1 bashkëngjitur.

9.4 Individët, të cilët deklarojnë të ardhurat nga punësimi, duhet të disponojnë:

9.4.1 kontratën e punës apo të shërbimit

9.4.2 dokumentacionin e pagesave ku pasqyrohet edhe tatimi i mbajtur në burim;

9.4.3 çdo dokument ligjor që vërteton shpenzimet për të cilat do të pretendohet zbritja nga baza tatimore (neni 22, paragrafi 1.d dhe 2), përfshirë certifikatën familjare, dokumentet për fëmijët në ngarkim të tij, dhe personave të tjerë që mund të ketë nën kujdestarinë e tij.

9.5 Në rastet kur tatimpaguesi pretendon kreditimin e tatimit të huaj, ai duhet të disponojë dokumentet në lidhje me ndonjë tatim të huaj të paguar i cili lejohet të zbritet nga tatimi i pagueshëm në Shqipëri, përfshirë: prova të qarta të deklaratës tatimore të të ardhurave në vendin tjetër, dokumentin e pagesës së tatimit të huaj apo dokumente të tjera autentike të autoriteteve të huaja kompetente që vërtetojnë pagesën e tatimeve në atë vend dhe që mund të kreditohen nga tatimi i pagueshëm në Shqipëri.

10. Të ardhurat personale të tatueshme

10.1 Të ardhura personale të tatueshme sipas Ligjit, konsiderohen të ardhurat nga punësimi sipas nenit 12, të ardhurat nga biznesi sipas nenit 13 dhe të ardhurat nga investimet (të ardhurat nga kapitali), të listuara në nenin 15 të Ligjit.

10.2 Të ardhurat personale janë të tatueshme pavarësisht faktit se paguhen në mjete monetare (lekë apo monedha të huaja) apo në natyrë. Në rastet kur të ardhurat personale janë realizuar në natyrë, ato vlerësohen me vlerën e tregut, konvertohen në lekë, duke llogaritur në këtë mënyrë bazën e tatimit mbi të cilën aplikohet tatimi sipas ligjit dhe detyrimi tatimor përkatës.

10.3 Llojet dhe kategoritë e të ardhurave në natyrë, por pa u kufizuar vetëm në to mund të përfshijnë:

10.3.1 pagesat në lidhje me shërbimet e kryera apo mallrat e furnizuara për të punësuarin, të vetpunësuarit apo tregtarin jo në para, por në aktive të tjera të ndryshme nga paratë.

10.3.2 aktivet (mallra, inventar etj) të dhuruara të punësuarit nga punëdhënësi

10.3.3 qera të paguara të punësuarit nga punëdhënësi

10.3.4 pagesa për trajtime estetike, operacione plastike, etj të kësaj natyre

10.3.5 pagesa për trajtime mjekësore kur nuk është parashikuar ndryshe në këtë ligj

10.3.6 pagesa për udhëtime private, akomodim privat pushime, etj të kësaj natyre, të paguara në favor të të punësuarit nga punëdhënësi, por që nuk lidhen me marrëdhëniet e punës dhe me realizimin e detyrave (shërbimet jashtë qendrës së punës, transporti, dietat, akomodimi)

10.3.7 aktive të tjera të luajtshme apo të paluajtshme të përfituara nga punëmarrësi

10.4 Të ardhurat e paguara në natyrë duhet të shoqërohen me dokumentacionin justifikues që provon shpenzimin e bërë në lidhje me aktivin/shërbimin e paguar si:

10.4.1 Faturat elektornike të paguara për trajtime estetike, mjekësore, udhëtime, akomodim, aktive të blera dhe të dhëna si shpërblim në natyrë.

10.4.2 Kontrata qeraje dhe dokumentacion pagesash për qera të paguar jo nga përfituesi i saj, jo më pak se nivelet e përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi për nivelet minimale të qerasë.

10.4.3 Kosto e argumentuar mallrash appo inventari të dhuruara punëmarrësit

10.4.4 Vlera e tregut e mallrave/shërbimeve të dhëna në këmbim të mallrave/shërbimeve të tjera të marra

11. Kategoritë e të ardhurave personale që nuk janë subjekt i Tatimit mbi të Ardhurat Personale

Në paragrafët “a” deri “h” të nenit 11, listohen kategoritë e të ardhurave personale, të cilat janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi mbi të ardhurat personalesi më poshtë:

11.1 Të ardhurat e përfituara si rezultat i sigurimit në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nënkuptojnë çdo të ardhur individuale që buron nga pagesat e bëra nga Fondi i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Kujdesit Shëndetësor. Pagesat e bëra nga fondit i sigurimeve shoqërore përfshijnë çdo lloj pagese për pension pleqërie, invaliditeti, kompensimi etj. Edhe pagesat e bëra nga Fondi i Kujdesit Shëndetësor, pavarësisht natyrës së tyre, janë të ardhura të përjashtuara nga tatimi për individët përfitues të tyre;

11.2 Ndhimat ekonomike nga buxhetet publike për individët pa të ardhura ose me të ardhura të ulta, sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi përfshijnë pagesa të tilla të dhëna nga pushteti qendror dhe ai lokal;

11.3 Të ardhurat e përjashtuara mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Marrëveshje të tilla duhet të kenë përcaktuar në mënyrë të qartë subjektet e përjashtuar nga tatimi. Zakonisht, marrëveshje të tilla parashikojnë përjashtime për stafet e huaja (individë jo rezidentë shqiptarë), ndërkohë që individët rezidentë shqiptarë i nënshtrohen legjislacionit të brendshëm tatimor dhe nuk përfitojnë nga Marrëveshje të tilla të ratifikuara; Përjashtimet që mund të jenë parashikuar në dokumente të cilat nuk janë ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pra që nuk prevalojnë mbi legjislacionin e brendshëm, nuk zbatohen;

11.4 Kompensimet financiare të paguara për pronarët e pronave si shpërblim për shpronësimet e bëra nga shteti për interesa publike, paguar nga buxheti qendror apo buxhetet lokale, si dhe kompensimet financiare që u jepen ish-pronarëve nga shteti për shpronësimet e pronës para vitit 1991;

11.5 Kompensimet financiare të paguara ish të dënuarve politikë dhe pasardhësve të tyre, dhe të përfituara sipas legjislacionit përkatës në fuqi;

11.6 Shpërblimet dhe çmimet e dhëna sportistëve, artistëve, studiuesve, shkencëtarëve etj, qoftë nga institucionet shtetërore apo organet e qeverisjes vendore, për rezultate dhe arritje në shkencë, sport, kulturë. Përjashtimi nga llogaritja dhe pagesa e tatimit për këto të ardhura, nuk i përjashton përfituesit nga detyrimi për dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave sipas kushteve të Ligjit;

11.7 Bursat e nxënësve dhe të studentëve të akorduara nga qeveria qendrore apo ajo lokale për nxënës dhe studentë me rezultate të larta, sipas akteve përkatëse të fushës;

11.8 Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore. Termi “dëmshpërblim” nuk përfshin përfitimet në formë pagash nga individët e larguar nga puna, për të cilët vendimi i gjykatës kërkon pagesën e pagave të papaguara. Këto përfitime do taten sikur pagat të ishin marrë çdo muaj për periudhën që mbulon vendimi i gjykatës.

12. Të Ardhurat nga Punësimi

12.1 Çdo përfitim i individit që ka lidhje me marrëdhëniet e punësimit, konsiderohet e ardhur nga punësimi dhe taten si e tillë, pavarësisht nëse është apo emertohet pagë, rrogë, shpërblim, bonus, shtesë, kompensim etj. Parimi kryesor që një e ardhur të konsiderohet si e ardhur nga punësimi është që individit tatimpagues duhet të ndjekë udhëzimet e pagesit të të ardhurave, pra punëdhënësit, apo personit që i ka caktuar një detyrë/funksion, në mënyrë që të marrë pagën/rrogën/shpërblimin/bonusin/kompensimin apo shtesën, apo elementë të tjerë të ngjashëm me këto. Brenda konceptit të të ardhurave nga punësimi janë paga bazë, për kohë punë apo sasi prodhimi, cdo shtesë mbi pagën bazë e përhershme si shtesat për pozicion, vjetërsi, vështirësi, largësi vendbanimi, natyrë të veçantë pune apo shërbimi, si dhe shtesa të tjera page e shpërblimi të tjera. Po kështu edhe të ardhurat që merr individit në formë shpërblimi nga fondi i veçantë, apo nga fonde të tjera të krijuara me akte të ndryshme ligjore apo statutore

të shoqërive, si paga e13-të, apo pagesa të ndryshme të kësaj natyre, konsiderohen të ardhura nga punësimi dhe konsolidohen në baze mujore për efekt të llogaritjes së detyrimit tatimor.

12.2 Edhe nëse pagesat bëhen për marrëdhënie punësimi apo detyrash që do konkretizohen në të ardhmen, apo për marrëdhënie punësimi apo detyrash që kanë ndodhur në të kaluarën, përfituesi konsiderohet se ka marrë të ardhura nga punësimi dhe do tatohet në bazë të rregullave të tatimit të të ardhurave nga punësimi.

12.3 Natyrën e të ardhurave nga punësimi kanë edhe shpërblimet e drejtorëve, shpërblimet si antar i bordit të drejtorëve ose i organit ligjor të një shoqërie, si dhe shpërblimet për menaxhimin dhe pjesëmarrjen në këshillat drejtues.

12.4 Në rastet kur pagesa të tilla, të cilat mund të jenë periodike, mujore/tremujore/vjetore sipas rastit, merren në vendin e punësimit të vazhdueshëm të individit, paguesi i tyre, pra agjenti i listëpagesës konsolidon të gjitha të ardhurat në bazë mujore dhe mban tatimin sipas normave ligjore në fuqi.

12.5 Në rastet kur pagesa të tilla, të cilat mund të jenë periodike, mujore/tremujore/vjetore sipas rastit, merren jo në vendin e punësimit, por në një entitet të ndryshëm me të cilin individit përfitues nuk ka marrëdhënie punësimi, entiteti pagues mban tatimin 15 % sipas përcaktimit në nenin 65 paragrafi 1 gërma “b” e ligjit. Meqenëse të ardhura të tilla konsiderohen të ardhura nga punësimi, individit përfitues ka detyrimin që në deklaratën vjetore të të ardhurave personale, të rillogaritë detyrimin tatimor duke bashkuar të ardhurat sipas paragrafit 1, gërmat “a”, “b”, “c” të nenit 12 të përfituara cdo muaj, me pagën mujore që mund të ketë marrë në vendin/vendet e punësimit dhe të paguajë/kerkojë të rimbursojë diferencat eventuale të detyrimit tatimor vjetor.

12.6 Edhe në rastet e transferimit apo huazimit të punonjësve, të ardhurat individuale të përfituara nga punonjësit do trajtohen si të ardhura nga punësimi dhe do tatohen si të tilla

12.7 Gërma “e” e paragrafit 1 të nenit 12 është “klauzolë antishmangie” dhe synon të mbrojë nga erodimi bazën e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, nëpërmjet kalimit të tatimpaguesit nga statusi “i punësuar” në statusin “i vetpunësuar” me qëllimin e vetëm të përfitimit të avantazheve fiskale duke aplikuar tarifa më favorizuese tatimi.

12.8 Nëse një i vetpunësuar, 80 % të të ardhurave i siguron nga 1 klient i vetëm, apo 90 % të të ardhurave nga më pak se 3 klientë, për qëllime të llogaritjes së detyrimit tatimor mbi të ardhurat vjetore/mujore të tij, do aplikohen tarifat e tatimit mbi pagën. Për qëllime të zbatimit të kësaj pike, llogaritja e detyrimit tatimor sipas këtij paragrafi, do bëhet nga vetë i vetpunësuar që plotëson këto kritere, në deklaratën tatimore vjetore të tij.

12.9 Në rastet kur i vetpunësuar, rezident tatimor me seli të përhershme në Shqipëri, siguron shërbime vetëm për persona jorezidentë shqiptarë, të cilët nuk kanë seli të përhershme në Shqipëri në formën e filialit, degës apo zyrës së përfaqësimit, gërma “e” e paragrafit 1 të nenit 12 nuk zbatohet.

12.10 Të ardhurat nga punësimi gjithashtu përfshijnë pagesat që kryhen në rastet e shkurtimit, humbjes ose ndërprerjes e marrëdhënieve të punësimit. Nëse një punëmarrës, merr në një shumë të vetme apo me disa pagesa, një të ardhur nga ish punëdhënësi i tij në formën e bonusit për shkurtimin e vendit të punës, apo mbylljes së vendit të punës, apo ndërprerjes së tyre për shkaqe nga më të ndryshmet, të ardhurat e paguara do të konsiderohen të

ardhura të muajit për të cilat janë paguar dhe do tatonen sipas normave tatimore të tatimit mbi pagat.

12.11 Nisur nga parimi që të ardhurat nga punësimi tatonen në vendin e punësimit, edhe në rastet kur fuqia punëtore ofrohet nga një agjenci punësimi e cila nuk është rezidente tatimore shqiptare, si psh rastet kur agjenci të huaja i ofrojnë entiteteve juridike shqiptare fuqi punëtore nga jashtë, por pagesa e fuqisë punëtore i bëhet agjencisë së huaj sipas kontratës, tatimi që llogaritet dhe mbahet si tatim mbi pagën do jetë jo më pak se 80 % e tarifës totale që është paguar nga entiteti shqiptar për agjencinë e huaj të punësimit.

Shembull: Një kompani ndërtimi shqiptare ka kërkuar nga një agjenci punësimi kineze që ta furnizojë me 50 punonjës karpentier, të cilët do të punojnë për një periudhë 6 mujore. Pagesa totale e cila përfshin koston e punës dhe komisionin e agjencisë është 380 mijë euro. Për nevoja të zbatimi të paragrafit 3 të nenit 12 të ligjit, fondi I pagave bruto supozohet të jetë $380.000 \times 80\% = 304.000$ euro. Secili punonjës supozohet të ketë përfituar: $304.000 : 6 \text{ muaj} : 50 \text{ punonjës} = 1.013$ euro në muaj. Kjo do të jetë baza mbi të cilën do të llogaritet detyrimi tatimor për çdo punonjës.

12.12 Nuk konsiderohen si të ardhura nga punësimi dhe nuk janë pjesë e bazës tatimore mbi të cilën llogaritet tatimi mbi pagat, përfitimet e mëposhtme të të punësuarve:

a) vlera e ushqimeve të konsumuara, pijeve (jo alkoolike), paisjet e punës, trajtimi mjekësor dhe përfitime të tjera të parashikuara, në ambjentet ku operohet nga ose në emër të një punëdhënësi, dhe që janë të disponueshme për të gjithë të punësuarit në kushte të ngjashme dhe që krijojnë kushte më të mira pune për të punësuarit. Përfitimet e të punësuarve sipas këtij paragrafi, konsiderohen jashtë bazës së tatimit, vetëm të rastet kur ofrohen si të tilla në natyrë nga punëdhënësi, qoftë për mallra apo shërbime, pra: (i) ose kur ato organizohen dhe ofrohen nga vetë punëdhënësi, psh ushqimi dhe pijet joalkoolike në mensën e entitetit, kabineti i mjekut apo dentistit në entitet, (ii) ose kur punëdhënësi i merr këto shërbime nga të tretët dhe punonjësit e tij marrin ushqim në një restorant të kontraktuar, apo kryejnë ekzaminime apo vizita mjekësore në një klinike. Në rastet kur punëdhënësi jep pagesa në mjete monetare të konsideruara si pagesa për trajtim ushqimor, mjekësor, blerje paisjesh si uniforma etj, pagesa të tilla të përfituara të mjete monetare nga punëmarrësi do konsiderohen pjesë e të ardhurave personale të tij nga paga dhe do tatonen si të tilla.

b) rimbursimet nga punëdhënësi i shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit dhe dietave. Përfitime të tilla duhet të justifikohen me dokumentacion, për të provuar se pagesa të tilla si përfitime të punëmarrësit, janë pjesë e përmbushjes së detyrave të tyre sipas kontratës, dhe janë kryer si pjesë e veprimtarisë ekonomike dhe për qëllime të menaxhimit të entitetit.

Dokumentacioni justifikues duhet të përfshijë edhe:

- autorizimin me shkrim të nivelit përkatës të menaxhimit për shërbimet për nevoja të punës. Menaxhimentit, duke treguar dhe arsyetuar qëllimin e udhëtimit për nevoja të punës, të lidhur me funksionet që kryen përfituesi;
- faturat e paguara si dokumente justifikuese, biletat e transportit, faturat e akomodimit apo dokumenta të tjera justifikuese.

c) kompensimet në formë ndihme për punonjësit në rastet e sëmundjeve, fatkeqësive apo vështirësive të jetesës që kanë, por brenda parashikimeve në legjislacionin përkatës në fuqi kur ka përcaktime të tilla. Paguesa dhe përfitime të tilla duhet të argumentohen me dokumentacion (psh ndihmë në rastin e vdekjes së familjarëve, pagesa për mjekime etj), por shuma totale e përfitimit nuk duhet të kalojë 20% të të ardhurave vjetore nga punësimi të punonjësit përfitues të shpërblimit/shpërblimeve;

d) Në rastet kur punëdhënësit sigurojnë të punësuarit në shoqëritë e sigurimit në lidhje me jetën, shëndetin dhe aksidentet në punë, pagesa të tilla në formën e kontributit për sigurimin e jetës, shëndetit dhe aksidenteve në punë, të bëra nga punëdhënësi në favor të punëmarrësit nuk konsiderohen pjesë e pagës mbi të cilën llogaritet tatimi mbi pagë.

e) në zbatim të Konventave apo Marrëveshjeve Ndërkombëtare të pranuar dhe nënshkruara nga Republika e Shqipërisë apo Qeveria Shqiptare, individët të cilët megjithëse mund të plotësojnë kriterin e rezidentit tatimor shqiptar, por që gëzojnë statusin diplomatik dhe janë pjesë e Misioneve të huaja diplomatike apo organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në Shqipëri, përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat që rrjedhin nga pagat dhe kompensimet për marrëdhëniet e punës së tyre, gjatë kryerjes së funksioneve të tyre zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

12.13 Në rastet kur një individ, merr të ardhura në formën e pagave, kompensimeve, dëmshpërblimeve etj, por që lidhen me punësimin e tij të kaluar dhe pagesa bëhet në një shumë të vetme apo në disa këste, të ardhurat e përfituara si pagë trajtohen si të ardhura nga punësimi të muajve dhe viteve për të cilat janë paguar dhe tatimi llogaritet sipas normave të tatimit mbi pagat të atyre periudhave tatimore. Ndërsa dëmshpërblimi tatohet me tarifën e parashikuar në paragrafin 65/1/b.

13. Të ardhurat nga biznesi

13.1 Në kuptim të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” të ardhurat nga biznesi i personave fizikë ku përfshihen tregtarët dhe të vetpunësuarit, përfshijnë, por pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e listuara në gërmat “a” deri “l” të nenit 13 të ligjit. Të ardhura të tilla, do trajtohen si të ardhura biznesi, nëse më parë nuk janë trajtuar si të ardhura nga punësimi, psh nëse jemi në kushtet e gërmës ‘e’ të paragrafit 1 të nenit 12, apo të gërmës ‘b’, paragrafi 1 i nenit 65:

- a. Të ardhurat e një personi fizik tregtar apo i vetpunësuar nga çdo aktivitet biznesi i tij, i çfarëdo lloji apo natyre;
- b. Të ardhurat që personi fizik tregtar apo personi fizik i vetpunësuar merr në formën e interesit, dividendit, ndarjes së fitimit, apo cdo honorari, por vetëm për rastet kur këto të ardhura janë pjesë e biznesit që ushtron personi fizik tregtar apo i vetpunësuar dhe jo pjesë e investimeve individuale të tij. *Shembull: Nëse një tatimpagues i vetpunësuar merr interesa nga llogaritë e tij të biznesit, apo ndonjë ndarje fitimi nga kuota që mund të ketë në një biznes tjetër, kuotë kjo që ka patur si burim financimi aktive e biznesit të të vetpunësuarit dhe jo llogari individuale të tij, këto kategori të ardhurash do trajtohen si të ardhura të biznesit;*
- c. Të ardhurat nga shitja e titujve, të cilat janë efektivisht të lidhura dhe pjesë e biznesit të tij;
- d. Të ardhurat nga dhënia me qira e një biznesi, pavarësisht se qiradhënia i përfshin të gjitha apo një pjesë të aktiveve të trupëzuara apo të patrupëzuara. *Shembull: Një*

tatimpagues, person fizik tregtar, apartamentin e tij në katin e parë e ka shndruar në dyqan, e ka regjistruar në Agjencinë e Kadastrës si të tillë dhe e ka futur si kontribut, pjesë të aktiveve të biznesit që ushtron. Nëse ky tregtar, një pjesë të dyqanit e jep me qera për një tregtar apo të vetpunësuar tjetër, të ardhurat nga qeraja do konsiderohen pjesë e të ardhurave të Biznesit të tij. Por nëse ai jep me qera një apartament tjetër që ka në pronësi si individ, të ardhurat që siguron nga kjo qeradhënie konsiderohen të ardhura individuale nga qeradhënia, tashmë sit ë tilla dhe nuk kanë lidhje me biznesin e tregtarit;

- e. Të ardhurat nga shitja e çdo lloj aktivi dhe detyrimi të biznesit, përfshirë edhe shitjen e të gjithë biznesit. Nëse aktivet janë regjistruar si pjesë e biznesit, të ardhurat nga shitja e tyre do jenë të ardhura biznesore. Nëse shitet i gjithë biznesi, përfshire aktivet e trupëzuara por edhe ato të patrupëzuara, e gjithë shuma e arkëtuar nga shitja është e ardhur e tatueshme biznesore, pavarësisht se shuma e arkëtuar mund të jetë më e lartë (për shkak të listës së klientëve, merit të mirë, pozicionit etj) se vlera e aktiveve të shitura në kuadrin e Biznesit;
- f. Të ardhurat nga prodhimi bujqësor ose blegtoral, për rastet kur ky prodhim tregtohet në kuadrin e një biznesi të regjistruar në QKB dhe të pajisur me NUIS si person fizik tregtar;
- g. Fitimi kapital i realizuar nga transferimi i aktiveve dhe pasiveve të biznesit në një riorganizim biznesi, siç përcaktohet në Nenin 46 “Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit” të këtij Ligji;
- h. Dhuratat, financimet apo subvencionet e marra nga një person fizik tregtar apo I vetpunësuar, të cilat jepen për biznesin e tij dhe pavarësisht kush është dhuruesi apo subvencionuesi. Të hyra të tilla në llogaritë e biznesit, konsiderohen të ardhura biznesore për efekt tatimi;
- i. Çdo lloj tarife shërbimi që faturon personi fizik për të tretë në kuadrin e biznesit të tij.
- j. Fitimet kapitale nga rivlerësimi i aktiveve të biznesit kur këto aktive janë dhënë si kontribut në natyrë në kapitalin e një kompanie, qoftë në themelimin e saj apo rritjen e kapitalit;
- k. Të ardhurat nga nxjerrja/përfitimi i mjeteve virtuale si dhe të ardhurat nga transaksionet me mjete virtuale të cilat janë efektivisht të lidhura me biznesin e tatimpaguesit.

13.2 Të ardhurat vjetore të tatueshme nga biznesi, përcaktohen si shuma e përgjithshme e të ardhurave të biznesit, pakësuar me shpenzimet përkatëse të dokumentuara dhe të kryera me qëllim fitimin, ruajtjen dhe sigurimin e të ardhurave. Të ardhurat vjetore të tatueshme të biznesit dhe shpenzimet e zbritshme duhet të llogariten në përputhje me Kreun 4 të këtij ligji.

14. Rregjimi i vecantë për individët tregtarë dhe të vetpunësuar

14.1 Për nevoja të deklarimit të të ardhurave tatimore nga biznesi, tatimpaguesi që ka statusin e personit fizik, tregtar apo i vetpunësuar mund të përdorë:

- a. Formën e plotë të deklarimit, ku ai duhet të evidentojë cdo shpenzim të zbritshëm biznesi dhe ti deklarojë ato sipas kërkesave të ligjit, duke llogaritur të ardhurat bruto nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimet e zbritshme, të ardhurën neto nga biznesi të tatueshme dhe tatimin mbi të ardhurat të llogaritur. Në këtë rast, tatimpaguesi do mbajë regjistrime të plota

në lidhje me shpenzimet e kryera dhe të pasqyruara në faturat elektronike të lëshuara nga furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve, regjistrime mbi llogaritjet e amortizimit të aseteve sipas grupeve nëse ka, regjistrime për interesa të paguara dhe shpenzime të tjera të zbritshme. Ndërkohë të ardhurat bruto nga biznesi duhet të pasqyrohen nëpërmjet faturave elektronike për shitjet biznes me biznes dhe faturave të pajisjeve fiskale për shitjet biznes me konsumator.

b. Me dëshirën e tij, tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat nga biznesi, por i cili ka realizuar qarkullim, pra të ardhura bruto nga biznesi sipas përcaktimeve për të ardhurat në nenin 13 të ligjit, jo më shumë se 10.000.000 lekë për vitin tatimor, mund të zgjedhë të zbatojë formën e shkurtuar të deklarimit të të ardhurave të tatueshme sipas nenit 14 të Ligjit, duke pasqyruar si shpenzime, të cilat zbriten nga e ardhura, shumën e supozuar në % të qarkullimit (të ardhurës bruto) sipas paragrafit 1 të nenit 14 për çdo kategori biznesi. Ndërkohë, të ardhurat bruto nga biznesi duhet të argumentohen dhe pasqyrohen nëpërmjet faturave elektronikë për shitjet biznes me biznes dhe faturave të pajisjeve fiskale për shitjet biznes me konsumator.

Nëqoftëse veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit nuk përfshin një vit të plotë, për efekt të llogaritjes së të ardhurave bruto, poshtë të cilave tatimpaguesi ka të drejtë të përdorë metodën e deklarimit me shpenzime të supozuara, e ardhura e periudhës konvertohet në të ardhur vjetore duke e pjestuar me numurin e muajve që ka ushtruar veprimtaria dhe shumëzuar me 12. Pavarësisht se tatimpaguesi mund të zgjedhë metodën e supozuar të shpenzimeve, ai është i detyruar të zbatojë detyrimet që ka në kuadrin e legjislacionit të fiskalizimit për pranimin e faturave nga furnizuesit e tij me mallra dhe shërbime, si dhe të evidentojë shitjet e mallrave dhe shërbimeve bazuar në kërkesat e këtij ligji. Gjithashtu ai është i detyruar të respektojë afatet e ruajtjes së dokumentacionit tatimor si për blerjet ashtu edhe për shitjet sipas dispozitave ligjore në fuqi si dhe çdo detyrim tjetër ligjor në lidhje me dhënien e informacionit dhe të dhënave për nevoja verifikimi dhe kontrolli tatimor, sipas procedurave dhe detyrimeve të parashikuara në Ligjin “Per procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre .

14.2 Deklarimi i të ardhurave të tatueshme qoftë me metodën e evidentimit të plotë të shpenzimeve, qoftë me metodën e supozuar të tyre, bëhet nëpërmjet Deklaratës së të ardhurave që janë pjesë e këtij Udhezimi.

14.3 Personi fizik, tregtar apo i vetpunësuar, mund të zgjedhë metodën sipas regjimit të vecantë me nivel shpenzimesh të supozuara, ose të zbatojë zbritjen e shpenzimeve bazuar në dokumentacion dhe fatura, me kusht që kalimi nga një metodë në tjetrën të mos ndodhë më shpesh se njëherë në pesë vjet. Pra nëse një person fizik zgjedh të përdorë regjimin e veçantë, ai do ta përdorë atë për të paktën 5 periudha tatimore. Në rast se në fund të periudhës 5 vjecare, personi fizik tregtar/i vetpunësuar zgjedh të mbajë dokumentacionin për evidentimin e shpenzimeve, ai bën njoftim pranë drejtorisë rajonale ku është i regjistruar për ndryshimin e regjimit të mbatjes së dokumentave të nevojshme për efekt të njohjes së shpenzimeve tatimore.

14.4 Tatimpaguesi, i cili ka zbritur shpenzimet në një shumë të vetme sipas rregjimit të vecantë, nuk lejohet të kërkojë zbritje apo kompensim tjetër përveç kompensimit personal sipas Nenit 22 “Zbritjet nga Baza Tatimore” të këtij ligji.

15. Të ardhurat nga investimet

15.1 Të ardhurat nga investimet për individët janë të ndryshme nga të ardhurat e tyre nga punësimi apo nga të ardhurat e biznesit në rastet kur individ i është person fizik tregtar apo i vetpunësuar.

15.2 Në kategorine e të ardhurave nga investimet, apo të ardhurave nga kapitali pasiv bëjnë pjesë të ardhura të tilla si: të ardhurat nga interesat e depozitave të kursimit, llogarive rrjedhëse, llogarive me afat apo pa afat, të ardhurat nga interesat e bonove të thesarit apo obligacioneve, të ardhurat nga dividendët apo ndarjet e fitimit, të ardhurat nga honoraret, fitimet kapitale nga tjetërsimi i letrave me vlerë, fitimet kapitale të realizuara nga skemat e sigurimit të jetës, kthimi i investimit nga skemat e pensionit privat, fitimi kapital nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme, të ardhurat nga qiraja e pasurive të paluajtshme, të ardhurat nga nxjerrja/përfitimi i mjeteve virtuale apo edhe të ardhurat nga transaksionet me mjetet virtuale.

15.3 Të tilla të ardhura të listuara në pikën 15.2 më lart, konsiderohet si të ardhura të individit, por nëse ndonjë nga këto të ardhura, sic është shpjeguar edhe në paragrafin 1 të nenit 13, është pjesë e biznesit të tregtarit apo të vetpunësuarit, ajo trajtohet si pjesë e të ardhurave të biznesit.

15.4 Të ardhura të përjashtuara të investimeve do të konsiderohen, të ardhurat nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, përveç tjetërsimit të automjeteve, aeroplanëve dhe anijeve në qoftë se ato shiten brenda më pak se 12 muajve nga blerja, të ardhurat nga transferimi i së drejtës së pronësisë së tokës bujqësore nga një fermer i regjistruar për një person fizik ose entitet i cili kryen një aktivitet bujqësor, si dhe në rastet kur pasardhësi ligjor trashëgimtar e mban tokën për të njëjtin qëllim dhe aktivitet. Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat edhe të ardhurat nga investimi në Eurobonde të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë, kur investitori është individ jo resident shqiptar.

16. Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e letrave me vlerë dhe mjeteve virtuale

16.1 E ardhura e tatueshme investimi nga tjetërsimi i aksioneve, pjesëmarrjeve dhe letrave me vlerë përcaktohet si diferencë ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së këtyre aseteve të tjetërsuara.

16.2 Nëse diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes të një aseti të tillë të tjetërsuar rezulton negativ në një vit tatimor (rezultojnë me humbje), një humbje e tillë mund të kompensohet me të ardhurat e tatueshme të investimeve nga tjetërsimi i letrave të tjera me vlerë në të njëjtin vit tatimor. Për mjetet virtuale, nëse të ardhurat e tatueshme të investimit nga tjetërsimi i tyre rezultojnë me humbje në një vit tatimor, të ardhurat e tatueshme të investimit konsiderohen të jenë zero, pra nuk zbatohet parimi i kompensimit me fitime të tjera kapitale.

16.3 Për letrat me vlerë të listuara në bursë, çmimet e blerjes dhe të shitjes përcaktohen nga dokumentet përkatëse të tregtimit në datën e shitjes ndërsa për letrat me vlerë të pa listuara, çmimi i shitjes përcaktohet në bazë të vlerës së kapitalit të shoqërisë që emeton letrat me vlerë në momentin e shitjes ose vlerës së tregut të deklaruar në marrëveshjen e transferimit, nëse kjo vlerë është më e lartë. Çmimi i blerjes përcaktohet në bazë të vlerës së kapitalit të shoqërisë që emeton letrat me vlerë në momentin e blerjes, ose të vlerës së përmendur në marrëveshjen e transferimit në momentin e blerjes së letrave me vlerë, cilado qoftë më e ulët. Nëse çmimi i

blerjes nuk mund të përcaktohet, ai konsiderohet të jetë zero. Gjithashtu në rastin e letrave me vlerë të fituara me trashëgimi ose dhurim, çmimi i blerjes për qëllime tatimore është vlera e tatueshme e letrave me vlerë të dhuruara ose trashëguara në momentin e përfitimit.

16.4 Tjetërsimi i letrave me vlerë përfshin kontributin në natyrë të letrave me vlerë si kapital fillestar ose një rritje kapitali e një entiteti.

17. Të ardhurat e tatueshme nga investimi për tjetërsimin e pasurive të paluajtshme

17.1 Procedurat e llogaritjes së të ardhurave, kostove dhe fitimeve sipas rasteve dhe nënrasteve në lidhje me fitimet kapitale që lidhen me tjetërsimin e pasurive të paluajtshme nga individët, sqarohen në Udhëzimin specifik të Ministrit Përgjigjës për Financat dhe Drejtuesit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

18. Të ardhurat vjetore të tatueshme nga Investimi

18.1 Të ardhurat vjetore të tatueshme nga investimi duhet të përfshijnë çdo të ardhur të tillë sipas përcaktimit në nenin 15 të ligjit dhe konsiderohen si shuma e përgjithshme e të ardhurave të tatueshme nga investimi.

19. Rregullat për entitetet e huaja të kontrolluara

19.1 Në nenin 19 të Ligjit, përcaktohen rregullat për tatimin e një personi fizik i cili ka një interes në një entitet të huaj i kontrolluar (EHK). Kur një person fizik ka një interes në një entitet të huaj të kontrolluar, fitimet e të cilit nuk i nënshtrohen tatimit ose janë të përjashtuara nga tatimi në Shqipëri, çdo fitim i pashpërndarë, i cili rrjedh nga 'të ardhurat pasive', duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme nga investimi i personit fizik.

19.2 Për të përcaktuar nëse zbatohen rregullat e EHK-së, duhet të marren në konsideratë dy probleme:

- a. nëse një njësi ekonomike e huaj është e llojit që do të konsiderohej EHK dhe,
- b. nëse personi fizik ka ndikim ose kontroll të mjaftueshëm mbi njësinë e huaj që subjekti i huaj të konsiderohet një EHK.

19.3 Çdo entitet i huaj konsiderohet entitet i huaj i kontrolluar kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

- a. personi fizik, ose së bashku me personat e lidhur, ka një pjesëmarrje direkte ose indirekte prej më shumë se 50 për qind të të drejtave të votës, ose zotëron direkt ose indirekt më shumë se 50 për qind të kapitalit, ose gëzon të drejtën të marrë më shumë se 50 për qind të fitimit të atij entiteti; dhe
- b. tatimi aktual i paguar mbi fitimin e tij nga entiteti është më pak se 50 për qind e tatimit që do t'i ngarkohej entitetit në rast se do të kishte qenë një entitet rezident në Shqipëri.

19.4 Hapi i parë për të përcaktuar EHK sipas paragrafit a) më sipër, është të identifikohet nëse personi fizik ka kontroll direkt apo indirekt të të drejtës së votës, të kapitalit apo fitimit të EHK dhe më pas të identifikojë nivelin e kontrollit të përcaktuar.

19.5 Hapi i dytë është krahasimi i tatimit të paguar nga EHK dhe tatimit që do të ishte paguar nëse shoqëria do të ishte rezidente në Shqipëri. Për këtë qëllim personi rezident paraqet dokumentat justifikuese për tatimin e paguar nga EHK ku specifikohet edhe norma tatimore.

Shembulli i mëposhtëm paraqet tatimin e paguar nga

Llogaritje mbi tatimin e paguar nga EHK	
Te ardhura	80 000
Shpenzimi tatimor	20 000
E ardhura e Tatueshme	60 000
Tatim fitimi i paguar (6%)	3 600
Tatimi i pagueshem ne Shqiperi	9 000

Nga shembulli i mësipërm rezulton se tatimi i paguar nga EHK është më pak se 50% e tatimit që do të ngarkohej shoqërisë nëse do të ishte rezidente në Shqipëri.

Nga testi i bërë për shembullin rezulton se përmbushet kushti i përcaktuar në paragrafin b), të nenit 19 të ligjit.

19.6 Me përfundimin e analizës për të përcaktuar nëse do të zbatohen rregullat e EHK, kryhet analiza e të ardhurave pasive. Të ardhurat pasive do të konsiderohen:

- a. interesat ose çdo e ardhur e realizuar nga aktivet financiare;
- b. honoraret ose çdo e ardhur tjetër e realizuar nga pronësia intelektuale;
- c. dividendët dhe të ardhurat nga shitja e letrave me vlerë;
- d. të ardhurat nga qiraja financiare.

19.7 Çdo fitim i pashpërndarë i cili rrjedh nga këto të ardhura pasive duhet të përfshihet në të ardhurat e tatueshme nga investimi të personit fizik që ka një interes në një EHK. Të tilla të ardhura do të deklarohen nga personi fizik nëpërmjet deklarataës tatimore vjetore të vitit të cilit i përket dita e 60-të nga përfundimi i vitit fiskal të CFC-së.

19.8 Këto të ardhura do të taten sipas shkallës tatimore të përcaktuara në paragrafin 3 të nenit 24. Ky rregull nuk zbatohet nëse të ardhurat pasive nuk kalojnë 30% të fitimit total të një EHK.

19.9 Kur entiteti i shpërndan fitimet personit fizik dhe ato fitime të shpërndara përfshihen në të ardhura të tatueshme të personit fizik, shumat e të ardhurave të përfshira më parë në bazën tatimore sipas këtij neni zbriten nga baza tatimore për llogaritjen e shumës së tatimit që i takon fitimeve të shpërndara.

19.10 Kur EHK ka paguar tatimin në shtetin e rezidencës ose vendbanimit mbi të ardhurat e përfshira në bazën tatimore të personit fizik sipas këtij neni, ky tatim mund të kreditohet kundrejt detyrimit të përgjithshëm tatimor. Kredia tatimore do të llogaritet sipas Nenit 25 “Kreditimi i tatimit të huaj”.

20. Tatimi i pensioneve private

20.1 Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni dhe kontributet e bëra nga punëdhënësi dhe çdo kontribues tjetër, në emër dhe për llogari të anëtarit të një fondi pensioni, nuk konsiderohen të ardhura të tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit të të ardhurave personale.

20.2 Pagesa e bërë nga vetë anëtari në fondin e pensionit vullnetar deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi, e parashikuar në kontratën që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit, është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo pagesë i zbritet së ardhurës personale të tatueshme përpara përlllogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale nga agjenti i mbajtjes së tatimit. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

20.3 Në rastet kur punëdhënësi ka krijuar një fond pensioni për punëmarrësin, kontributet e paguara prej punëdhënësit në fondin e pensionit për llogari të punëmarrësit nuk janë pjesë e së ardhurës së tatueshme për efekt të llogaritjes së tatimit mbi të ardhurat personale dhe konsiderohen shpenzim operativ, deri në shumën vjetore për çdo punëmarrës, të barabartë me pagën minimale vjetore të miratuar në shkallë vendi dhe kjo shumë vlerësohet shpenzim i njohur, për qëllime të tatimit mbi fitimin.

20.4 Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar. Në rastet kur një kontribues tjetër i ndryshëm nga vetë anëtari ose punëdhënësi derdh një kontribut në emër të anëtarit të fondit, ky kontribut është i përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale nga paga. Dokumenti justifikues është kontrata që anëtari i fondit ka me shoqërinë administruese të fondit të pensionit vullnetar.

20.5 Në rast se anëtari i fondit tërheq para kohe fondin e pensionit ai tatonet me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra parakohe, përfshirë kontributet.

20.6 Për anëtarët e fondit të pensionit, të cilët kanë investuar në fond kursimet e tyre individuale të taksuara më parë, tatimit për kthimin nga investimi me normën në fuqi i bëhet zbritje 15 % e detyrimit të tatimit për tu paguar. Antari duhet të provojë me dokumente se fondet e përdorura për këtë investim, kanë qënë të taksuara sit ë ardhura personale.

20.7 Pagesat e marra nga antari i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme, përpara afatit të marrjes së tyre në mënyrë periodike mujore siç parashikohet në ligjin për fondet e pensionit privat, tatonen me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra, përfshirë kontributet.

21. Baza Tatimore Vjetore

21.1 Për efekt të përcaktimit të bazës tatimore vjetore të të ardhurave të individit, merren në konsideratë të tre kategoritë e të ardhurave: të ardhurat vjetore të tatueshme të punësimit, të ardhurat vjetore të tatueshme të biznesit dhe të ardhurat vjetore të tatueshme të investimeve. Kjo bazë tatimore vjetore zvogëlohet me kompensimet dhe zbritjet e përcaktuara sipas ligjit.

21.2 Për tre kategoritë e të ardhurave personale të cilat përbëjnë bazën e tatueshme, tarifat tatimore aplikohen në mënyrë individuale për cdo kategori, sipas përcaktimeve në ligj:

- a. të ardhurat nga punësimi tatonen sipas normave progresive 13 % dhe 23 %;

- b. të ardhurat neto nga biznesi taten sipas normave progresive 15 dhe 23 %;
- c. të ardhurat nga investimi taten sipas normave respektive 8 % dividendët dhe ndarjet e fitimit dhe 15 % të ardhurat e tjera nga investimi

22. Zbritjet nga baza tatimore

22.1 Tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi dhe nga biznesi, mund të zbrisë nga baza tatimore respektive për periudhën tatimore:

- a. një shumë prej 600.000 lekë nëse të ardhurat vjetore janë deri 600.000 lekë;
- b. një shumë prej 420.000 lekë nëse të ardhurat vjetore janë mbi 600.000 lekë deri në 720.000 lekë;
- c. një shumë prej 360.000 lekë nëse të ardhurat vjetore janë mbi 720.000 lekë;
- d. një shumë kompensimi për çdo fëmijë në ngarkim të tij më pak se 18 vjeç dhe që jeton së bashku me tatimpaguesin në një familje të përbashkët prej 48,000 lekë.

22.2 Kërkesën për zbritjet personale, tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi, mund ta kërkojë nëpërmjet Deklaratës, nga agjenti i tij tatimor i listëpagesës në bazë mujore, në vlerën prej 1/12 e shumës së përmendur në nenin 22, Paragrafi 1. Zbritja personale mund të pretendohet vetëm një herë në një vit tatimor.

22.3 Tatimpaguesi i cili kërkon zbritjen personale apo pjesë të saj, nuk mund ta kërkojë më shumë se një herë në një muaj. Agjenti tatimor i listëpagesës është i detyruar të marrë në konsideratë në baza mujore 1/12 zbritjet dhe llogarit në listëpagesë tatimin mbi të ardhurat për të punësuarin që ka nënshkruar deklaratën mbi statusin personal me këtë agjent tatimor të listëpagesës. Punëmarrës nuk mund të nënshkruajë deklaratën për statusin personal me më shumë se një agjent tatimor të listëpagesës për të njëjtën periudhë kalendarike mujore.

22.4 Ndërsa, kërkesa për zbritje nga baza tatimore në lidhje me kompensimin për fëmijën në ngarkim të tij bëhet nga anëtari i familjes me të ardhura më të larta vjetore të tatueshme, nëpërmjet deklaratës vjetore të të ardhurave.

Shembull 1:

Iliri punon me kohë të plotë si financier në kompaninë "XX" dhe ka pagë bruto 70,000 lekë/muaj ose 840,000 lekë/vit. Ndërkohë, punon dhe në një zyrë kontabël me kohë të pjesme me një pagë 40,000 lekë/muaj ose 480,000 lekë/vit.

Llogaritja e zbritjes nga baza tatimore:

Iliri zgjedh të nënshkruajë Deklaratën e Statusit Personal me zyrën kontabël. Zyra kontabël mban tatimin mbi të ardhurat nga punësimi, si dhe është i detyruar të marrë në konsideratë në baza mujore 1/12 e zbritjeve nga baza e tatimit. Konkretisht e ardhura tatimore e Ilirit nga zyra kontabël është 480,000 lekë/vit. Ligji thotë se për pagat deri në 600.000 lekë/vit, aplikohet një zbritje deri në 600.000 lekë/vit. Në rastin konkret agjenti tatimor duhet të aplikojë një zbritje mujore prej 600.000lekë/12 pra 50,000 lekë në muaj. Punëmarrësi ka një pagë prej 40,000 lekë/muaj në zyrën kontabël ku pasi i aplikojmë zbritjen tatimore, baza e tatueshme mbetet zero dhe në këtë rast punëmarrësi nuk paguan tatimin e të ardhurave nga punësimi për të ardhurat në zyrën kontabël.

Kompania "XX", referuar ", paragrafit 1, të nenit 65, aplikon një tatim progresiv 13% dhe 23% sipas paragrafit 1 të nenit 24 të ligjit mbi pagën dhe nuk aplikon zbritje nga baza tatimore

Tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale me të ardhura vjetore të tatueshme nga punësimi, të ardhura vjetore të tatueshme nga biznesi dhe të ardhura vjetore të tatueshme nga investimi më pak se 1.2.000.000 lekë mund të zbresë përveç shumave individuale sipas paragrafit më sipër, shpenzimet korrente për:

- a. shpenzimet për arsimin e fëmijëve në ngarkim të tij, në vlerën maksimale 100,000 lekë;
- b. medikamentet për fëmijët e tij ose në ngarkim të tij dhe personave që ka nën kujdestarinë e vet, në vlerën maksimale 30.000 lekë.

Kërkesa për zbritje nga baza tatimore në lidhje me shpenzimet për arsim dhe medikamente bëhet nga anëtari i familjes me të ardhura më të larta vjetore të tatueshme, nëpërmjet deklaratës vjetore të të ardhurave.

23. Kërkesa për zbritje

23.1 Kompensimi për fëmijën në ngarkim të tij dhe shpenzimet për arsim dhe medikamente kërkohen nga anëtari i familjes me të ardhura më të larta vjetore të tatueshme. Ai duhet të paraqesë dokumenta justifikues të tilla si certifikatën e gjendjes familjare, kontratat me institucionet arsimore dhe dokumentet e pagesës, dokumentin e mjekut dhe faturat e medikamenteve të blera për fëmijët etj.

23.2 Tatimpaguesi i të ardhurave personale me të ardhura nga punësimi, nëpërmjet Deklaratës, mund të kërkojë zbritjet personale nga agjenti i tij tatimor i listëpagesës në bazë mujore, në vlerën prej 1/12 e shumës së përmendur në nenin 22, Paragrafi 1/a,b,c. Zbritja personale mund të pretendohet vetëm një herë në një vit tatimor. Tatimpaguesi i cili kërkon zbritjen personale apo pjesë të saj, nuk mund ta kërkojë më shumë se një herë në një muaj. Zbritjet e tjera përveç zbritjeve personale në përputhje me nenin 22, paragrafi 1/a,b,c, mund të kërkohen vetëm nëpërmjet deklaratës vjetore të të ardhurave.

24. Norma tatimore

24.1 Për të ardhurat nga punësimi, normat tatimore që zbatohen janë 13 % dhe 23 %. Reduktimi i ngarkesës tatimore për të punësuarit me të ardhura të ulta, nuk bëhet nëpërmjet aplikimit të tarifës 0 % për një segment të caktuar page, por duke reduktuar bazën e tatimit (pagen bruto) me një shumë të caktuar të parashikuar në nenin 22 të ligjit.

24.2 Për të ardhurat nga biznesi, për të cilat baza e tatimit është e ardhura neto pra diferenca e të ardhurave minus shpenzimet e zbritshme, zbatohen normat:

- a. 15% për fitimet neto deri në 14.000.000 lekë në një vit tatimor
- b. 23 % për cdo lek fitim neto mbi fitimin neto 14.000.000 lekë në vit

24.3 Nëse një person fizik tregtar apo i vetpunësuar, pasi nga e ardhura bruto ka zbritur çdo shpenzim të zbritshëm dhe çdo zbritje të lejuar sipas nenit 22 të ligjit, deklaron fitim neto 12.000.000 lekë, tatimi që do paguajë do jetë $12.000.000 \times 15\% = 1.800.000$ lekë.

24.4 Nëse një person fizik tregtar apo i vetpunësuar, pasi nga e ardhura bruto ka zbritur çdo shpenzim të zbritshëm dhe çdo zbritje të lejuar sipas nenit 22 të ligjit, deklaron fitim neto

20.000.000 lekë, tatimi që do paguajë do jetë: $14.000.000 \times 15\% + 6.000.000 \times 23\% = 2.100.000 + 1.380.000 = 3.480.000$ lekë.

24.5 Të ardhurat nga investimi taten përkatësisht 8% të ardhurat nga dividendët/ndarjet e fitimit dhe 15% çdo zë tjetër i të ardhurave nga investimi. Përveçse kur parashikohet ndryshe në ligj, asnjë kosto nuk zbritet kundrejt të ardhurave nga investimi.

24.6 Shembuj të llogaritjes së tatimit:

Ana punon në një zyrë programimi dhe paga e saj bruto është 230,000 lekë/muaj ose 2,760,000 lekë/vit. Bashkëshorti i Anës ka një biznes për tregtimin e pajisjeve hidro-sanitare dhe ka të ardhura neto 3,250,000 lekë/vit. Ndërkohë Ana ka një depozitë me afat nga e cila merr një normë interesi 20,000 lekë/vit, ndërkohë Beni ka disa aksione në kompaninë "XX" e cila për këtë vit ka paguar dividendë në vlerën 25,000 lekë/vit. Ana dhe Beni kanë dhe tre fëmijë përkatësisht 13, 15 dhe 18 vjeç.

a. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi:

Ana ka të ardhura vjetore nga punësimi në shumën 2,760,000 lekë, pra të ardhurat e saj e kalojnë shumën prej 600,000 lekë dhe zbritja nga baza tatimore që Ana përfiton, referuar paragrafit 1 të nenit 22 të ligjit është 360,000 lekë. Gjithashtu Ana ka dy fëmijë nën moshën 18 vjeç për të cilët për të cilët përfitohet një kompensim nga baza tatimore prej 48,000 lekë për fëmijë, pra 96,000 lekë në total megjithatë, duke qenë e Beni ka të ardhura më të larta, do të jetë Beni ai që do ta kërkojë këtë kompensim nga baza tatimore, si dhe zbritjet e parashikuara në paragrafin 2 të nenit 22. Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi që Ana do të paguajë do të jetë:

Të ardhurat vjetore nga punësimi prej 2,760,000 lekë/vit zvogelohen me zbritjet e parashikuara sipas këtij ligji. $2,760,000 \text{ lekë/vit} - 360,000 \text{ lekë/vit} = 2,400,000 \text{ lekë/vit}$

E ardhura vjetore, pasi aplikohen zbritjet dhe kompensimet taten:

$2,040,000 \text{ lekë/vit} \times 13\% + (2,400,000 \text{ lekë/vit} - 2,040,000 \text{ lekë/vit}) \times 23\% = 265,200 \text{ lekë/vit} + 82,800 \text{ lekë/vit} = 348,000 \text{ lekë në/vit}$ tatimi që Ana paguan për të ardhurat nga punësimi.

b. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga biznesi:

Beni ka të ardhura neto vjetore si i vetëpunësuar në shumën 3,250,000 lekë. Referuar paragrafit 1 të nenit 22, të ardhurat e Benit janë mbi 600,000 lekë/vit, prandaj zbritja nga baza tatimore që Beni përfiton është 360,000 lekë. Beni si tatimpaguesi me të ardhurat më të larta në familje do të përfitojë një kompensim nga baza tatimore prej 48,000 lekë për çdo fëmijë në moshën nën 18 vjeç, pra 96,000 lekë në total për dy fëmijët që janë më pak se 18 vjeç. Ndërkohë, Beni nuk i përfiton zbritjet nga baza tatimore të parashikuara në paragrafin 2 të nenit 22, duke qenë se të ardhurat vjetore janë më të larta se 2,000,000 lekë.

Të ardhurat neto vjetore nga biznesi zvogëlohen nga zbritjet tatimore dhe kompensimet e parashikuara sipas këtij ligji.

$3,250,000 \text{ lekë/vit} - (360,000 \text{ lekë/vit} + 96,000 \text{ lekë/vit}) = 2,890,000 \text{ lekë/vit}$

E ardhura vjetore, pasi aplikohen zbritjet dhe kompensimet taten:

$2,794,000 \text{ lekë/vit} \times 13\% = 363,220 \text{ lekë/vit}$ tatimi që Beni paguan për të ardhurat nga biznesi.

c. Llogaritja e tatimit mbi të ardhurat nga investimi:

Të ardhurat nga depozita me afat e Anës dhe të ardhurat nga dividendët që Beni ka marrë nga investimi në aksione, janë të ardhura nga investimi. Tatimpaguesit e të ardhurave nga investimi mund të zbresin nga baza tatimore zbritjet sipas paragrafit 2 të nenit 22, por këto zbritje nuk përfitohen nga tatimpaguesit në fjalë, sepse të ardhurat e Benit e tejkalojnë shumën 2,000,000 lekë/vit.

Tatimi mbi të ardhurat nga investimi, që do të paguajë Ana, për interesat e përfituara nga depozita me afat do të jetë: $20,000 \text{ lekë/vit} * 15\% = 3,000 \text{ lekë}$

Tatimi mbi të ardhurat nga investimi, që do të paguajë Beni, për dividendën e përfituar nga investimi në aksione do të jetë: $25,000 \text{ lekë/vit} * 8\% = 2,000 \text{ lekë}$

25. Kreditimi i tatimit të huaj.

25.1 Neni 25 ka të bëjë me kreditimin e tatimit që tatimpagues rezidentë të tatimit mbi të ardhurat personale në Republikën e Shqipërisë kanë paguar në vende të tjera (jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë) për të ardhurat që ata kanë realizuar në ato vende. Por ky reduktim nuk do të kalojë nivelin e tatimit që do të aplikohet mbi ato të ardhura sikur ato të realizoheshin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në bazë të legjislacionit fiskal shqiptar.

25.2 Shuma e tatimit të huaj të paguar në vendet e tjera vertetohet nga dokumentacioni justifikues përfshirë deklaratën dhe pagesën e tatimit në atë vend, apo dokumentin e lëshuar nga autoriteti i huaj tatimor në të cilin janë realizuar të ardhurat. Dokumentacioni justifikues duhet të përmbajë informacionet identifikuese të tatimpaguesit rezident, natyrën e të ardhurës së përfituar, shumën bruto të të ardhurës dhe tatimin e mbajtur në shtetit tjetër si dhe vitin tatimor në të cilin të ardhurat janë realizuar.

25.3 Nëse tatimpaguesi ka realizuar të ardhura me burime nga vende të huaja në më shumë se një shtet, atëherë kreditimi i tatimit të huaj llogaritet vecmas për secilin shtet bazuar në dokumentin e lëshuar nga autoriteti tatimor i huaj.

25.4 Kreditimi i tatimit të huaj llogaritet vecmas për secilën nga të ardhurat e përfshira në bazën tatimore si dhe për të ardhurat vjetore nga investimi.

26. Llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat personale.

Tatimi mbi të ardhurat personale llogaritet bazuar në të ardhurat e tatueshme, në përputhje me nenin 24 të ligjit sipas normave tatimore të përcaktuara për secilën kategori të ardhurash.

Nga tatimi i llogaritur zbriten tatimet e paguara nga tatimpaguesi më parë sic janë: tatim i paguar në vendin e huaj, tatimi i mbajtur në burim, tatim i mbajtur në burim për të ardhurat nga marrëdhëniet e punës nga agjenti i tatimit të listëpagesës dhe parapagimet sipas nenit 63 të ligjit.

Nëse nga llogaritja e tatimit të pagueshëm (sipas paragrafit të mësipërm) diferenca del negative, tatimpaguesi i të ardhurave personale mund të kërkojë tatimin e paguar më tepër dhe administrata tatimore do t'i kthejë atij shumën e mbipaguar jo më vonë se 60 ditë nga aplikimi i kërkesës. **Kërkesa bëhet nëpërmjet llogarisë së tatimpaguesit në sistemin e-cats. Administrata**

tatimore pas verifikimit të dokumentacionit që vërteton tatimin e paguar tatimi i mbajtur në burim, tatim i mbajtur në burim për të ardhurat nga marrëdhëniet e punës nga agjenti i tatimit të listëpagesës dhe parapagimet, miraton kërkesën për rimbursim. Jo më vonë se se 60 ditë nga aplikimi i kërkesës Administrata rimbruson shumën e tatimit të paguar më tepër.

Në rast se tatimpaguesi nuk kërkon kthimin e tatimit të paguar tepër mbi të ardhurat personale, kjo shumë konsiderohet pagesë në avancë për tatimin mbi të ardhurat personale të periudhës tatimore vijuese.

TATIMI MBI TË ARDHURAT E KORPORATËS

27. Tatimpaguesit për tatimin mbi të ardhurat e korporatave

27.1 Entitetet e krijuar sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatave ('tatimpagues i tatimin mbi fitimin korporativ').

27.2 Gjithashtu, tatimit mbi fitimin korporativ, i nënshtrohet cdo entitet tjetër, përfshirë entitetet jorezidente, të cilat krijojnë seli të përhershme në Shqipëri, në formën e filialit, degës apo cdo forme tjetër, dhe të cilës i atribuohen fitimet me burim në Shqipëri dhe që nuk janë parashikuar në shkronjat "a" deri "d" të paragrafit 1 të nenit 27 të Ligjit.

27.3 Tatimit mbi fitimin korporativ i nënshtrohen edhe entitetet të cilat trajtohen sipas një rregjimi të veçantë tatimor si psh operatorët që i nënshtrohen sistemit fiskal për hidrokarburet.

27.4 Entitetet e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat e korporatës sipas paragrafit 2 të nenit 27 të Ligjit, të cilat detyrohen të dorëzojnë në organet tatimore Deklaratën Tatimore dhe Pasqyrat e Raportimit Financiar, në të njëjtat afate si entitetet e tjera, janë:

- a. Fondacionet ose institucionet financiare jo bankare të krijuara ose transferuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, që synojnë mbështetjen e politikave zhvilluese të qeverisë nëpërmjet dhënies së kredive;
- b. Fondi i pensionit privat i administruar nga shoqëria e menaxhimit, si dhe shoqëria e administrimit të fondit;
- c. Entitetet që ushtrojnë vetëm veprimtari të karakterit fetar, humanitar, bamirës, shkencor apo edukativ, studimor, pasuria apo fitimi i të cilëve nuk përdoret për përfitimin e organizuesve apo anëtarëve të tyre dhe brenda limiteve të aktivitetit jo tregtar të ushtruar prej tyre;
- d. Entitetet e parashikuara në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi;
- e. Shtëpitë filmike të prodhimit kinematografik, të liçensuara dhe të subvencionuara nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë;
- f. Organizatat e punës apo dhomat e tregëtisë, industrisë ose bujqësisë, pasuria apo fitimi i të cilave nuk përdoret për përfitimin e një individi apo të një anëtar të tyre.

27.5 Të gjitha entitetet e përmendura në paragrafin e mësipërm, pavarësisht nga përjashtimi i tatimit mbi të ardhurat e korporatës, janë të detyruara të dorëzojnë në organet tatimore deklaratën tatimore dhe Pasqyrat e Raportimit Financiar, në të njëjtat afate si entitetet, që i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatës.

27.6 Entitetet që ushtrojnë veprimtari të karakterit edukativ, studimor, shkencor, humanitar, bamirës, fetar etj, duhet të japin të dhëna në lidhje me të ardhburat e tyre dhe burimet e financimit si dhe drejtimet ku shpenzohen apo, duke detajuar strukturën e këtyre shpenzimeve.

28. Rezidenca

28.1 Përkufizimi i konceptit të rezidencës së entitetit është i rëndësishëm për të përcaktuar dhe ndarë të drejtën tatimore. Entitetet e krijuara sipas legjislacionit shqiptar në fuqi, apo sipas ndonjë legjislacioni të huaj, dhe që krijojnë seli të përhershme në Shqipëri, janë subjekt i tatimeve sipas këtij Ligji

28.2 Gjithashtu, nëse një entitet i krijuar apo jo sipas legjislacionit shqiptar, menaxhimin dhe kontrollin e punëve i ushtron në Republikën e Shqipërisë, në çdo kohë gjatë vitit tatimor, konsiderohet rezident tatimor shqiptar për qëllime tatimore.

28.3 Menaxhimi dhe kontrolli i punëve të një entiteti konsiderohet se ushtrohet në Republikën e Shqipërisë nëse:

- a. mbledhjet e bordit drejtues të entitetit mbahen në Republikën e Shqipërisë, përfshirë edhe pjesëmarrjen online të antarëve, ose;
- b. plotësohen të paktën dy nga tre kushtet e mëposhtme:
 - i. vendimet në lidhje me drejtimin e përditshëm të entitetit merren në Republikën e Shqipërisë;
 - ii. të paktën 50 për qind e anëtarëve të bordit ose drejtuesve të entitetit janë rezidentë në Republikën e Shqipërisë;
 - iii. të paktën 50 për qind e kapitalit ose e të drejtave të votës së entitetit zotërohen, direkt ose indirekt, nga persona rezidentë në Republikën e Shqipërisë.

29. Përfshirja në pjesëmarrje

29.1 Për rastet kur entitetet të cilat janë subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ sipas Ligjit, kanë/zotërojnë pjesëmarrje, kuota apo aksione në entitete të tjera, dividendi apo shpërndarja e fitimit nga këto entitete të tjera dhe i marrë si e ardhur nga entiteti që ka kuota pjesëmarrjeje trajtohet si më poshtë:

- a. E ardhura e marrë si dividend apo ndarje fitimi nuk i bashkohet fitimit mbi të cilin llogaritet tatimi mbi fitimin nëse plotësohen në mënyrë kumulative dy kushte:
 - i. entiteti marrës ka aksione apo pjesëmarrje prej të paktën 10%, në vlerë ose në numër, në kapitalin aksioner, ose të drejtat e votimit të entitetit shpërndarës;
 - ii. aksionet ose pjesëmarrja minimale janë mbajtur për një periudhë të pandërprerë prej së paku 24 muajsh.
- b. Në të gjitha rastet e tjera, e ardhura e marrë si dividend apo ndarje fitimi i bashkohet fitimit mbi të cilin llogaritet tatimi mbi fitimin.

29.2 Rregullat sipas paragrafeve “a” dhe “b” më sipër, zbatohen edhe për entitetet jo rezidente të tatimit mbi të ardhurat e korporatës, nëse pjesëmarrja ka të bëjë me veprimtaritë e biznesit të kryera nga një jo-rezident në Shqipëri, ose nëpërmjet një selie të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

29.3 Garancia e përmendur në paragrafin “4” të Ligjit, nënkupton garanci të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, e cila garanton në cdo kohë që me kërkesën e Administratës Tatimore, të kalojë në llogarinë e kësaj të fundit shumën e garancisë.

30. Rregullat e Kufizimit të Interesit

30.1 Për qëllime të zbatimit të rregullit të kufizimit të interesit, konsiderohet shpenzim i zbritshëm interesi deri në tridhjetë për qind (30%) të fitimeve të subjektit para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA) të vitit tatimor.

30.2 EBITDA do të llogaritet duke i shtuar të ardhurave që i nënshtrohen tatimit, shumat e rregulluara nga tatimi për interesat e tepërta, si dhe shumat e rregulluara nga tatimi për zhvlerësimin dhe amortizimin. Të ardhurat e përjashtuara nga tatimi do të përjashtohen nga EBITDA e entitetit.

30.3 “Interesi i tepërt”, ndryshe kosto e tejkaluar e huamarrjes lind kur shpenzimet e interesit të një entiteti janë më të madha se të ardhurat e tatueshme nga interesi dhe të ardhurat e tjera të tatueshme ekonomikisht ekuivalente që merr entiteti.

30.4 Llogaritja e kostove të zbritshme të tejkalimit të huamarrjes dhe bartja.

Hapi i parë, llogaritja e EBITDA = Të ardhurat neto + Tatime + shpenzimet e interesit + Amortizimi & Zhvlerësimet

Hapi i dytë është llogaritja e shpenzimit të lejuar të interesit të tepërt.

Shembull;

Të dhënat financiare për shoqëritë A dhe B jepen në tabelën e mëposhtme;

	<i>Shoqëria A (në lekë)</i>	<i>Shoqëria B (në lekë)</i>
<i>teprica e shpenzimeve neto të interesit</i>	<i>+10 milion</i>	<i>+40 milion</i>
<i>=EBITDA</i>	<i>= 100 milion</i>	<i>= 100 milion</i>
<i>× përqindjen e vendosur</i>	<i>×30%</i>	<i>×30%</i>
<i>= maksimumi i lejuar si shpenzime të zbritshme</i>	<i>=30 milion</i>	<i>=30 milion</i>
<i>Shpenzimet neto të interesave të pazbritshme</i>	<i>0</i>	<i>10 milion</i>

30.5 Shoqëria A ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 10 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive/huamarrjeve/financimeve, që shoqëria A ka me palët tjetra. Për shkak se shoqëria A

ka një raport interesi neto / EBITDA nën 30%, ajo mund të zbrësë të gjithë shpenzimet neto të interesit.

30.6 Shoqëria B ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 40 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë Lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive/huamarrjeve/financimeve, që shoqëria B ka me palët e treta. Për shkak se shoqëria B ka një raport interesi neto/ EBITDA mbi 30%, ajo nuk mund të zbrësë të gjithë shpenzimet neto të interesit. Shoqëria B në këtë rast lejohet të zbrësë 30 milionë lekë shpenzime neto interesi dhe 10 milionë lekë nuk lejohen të zbriten, por mbarten në periudhat e ardhshme tatimore.

30.7 Interesi për të cilin refuzohet zbritja mbartet për 5 vitet e ardhshme. Tatimpaguesit për këtë qëllime mban evidenca të intereseit të mbartur sipas viteve të cilat ato i përkasin. Zbritja e interesit të tepërt bëhet sipas metodës FIFO.

30.8 Rregulli i përcaktuar në këtë paragraf nuk zbatohet për:

- a. bankat, institucionet financiare jobankare të kredithënies, shoqëritë e sigurimit dhe shoqëritë e lizingut;
- b. interesat lidhur me kreditë e përdorura për financimin e një projekti afatgjatë të infrastrukturës publike ku operatori i projektit, kostot e huamarrjes, asetet dhe të ardhurat janë të gjitha në Republikën e Shqipërisë.

31. Rezerva e borxhit të keq për institucionet financiare

31.1 Për institucionet financiare, veprimtaria e të cilave rregullohet nga autoritetet rregullatore, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm, lejohet zbritje për shumat që do të vendosen dhe / ose rrisin por duke u kufizuar në:

- a. Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit, në rezervat teknike të detyrueshme të krijuara në zbatim të ligjit në fuqi për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit; dhe
- b. Për veprimtarinë bankare, në provigjionet e detyrueshme për bankat tregtare dhe institucionet e tjera financiare të krijuara sipas rregullave mbikëqyrëse të nxjerra nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

31.2 Zbritja e plotë e borxhit të keq lejohet nëse kushtet e mëposhtme përmbushen në mënyrë kumulative:

- a. Entiteti ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për të mbledhur borxhin. Duhet që të jenë zbatuar parashikimet e neneve të kontratave të huadhënies/sigurimit, në lidhje me kushtet dhe penalitetet në rastet e moskthimit të huasë/interesave. Në cdo rast, argumentimi me procese gjyqësore administrative ku ka vendime të formës së prerë është i domosdoshëm;
- b. Për shkak të pamundësisë së mbledhjes së tij, edhe pse janë konsumuar të gjitha mjetet ligjore sic parashikohet në paragrafin “a” më sipër, borxhi i keq hiqet nga kontabiliteti i entitetit kërkues;

- c. Në cdo rast, rezerva ose dispozitat e krijuara sipas paragrafit 1 më sipër, duhet t'i shtohet fitimit të tatueshëm.

31.3 Nëse më parë është krijuar një rezervë e borxhit të keq për një rast të caktuar, por ky rast ka marrë zgjidhje, shuma e arkëtuar/rikuperuar duhet t'i shtohet fitimit të tatueshëm në vitin që rikuperohet, përveç se kur transferohet në lidhje me një riorganizim biznesi sipas nenit 46 "Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e biznesit", të këtij ligji.

32 - 39. Procedurat në lidhje me:

- a. Transferimi i çmimeve;
- b. Krahasueshmërinë e transaksioneve;
- c. Metodat e transferimit të çmimit;
- d. Vlerësimin e transaksioneve të kontrolluara të kombinuara;
- e. Diapazonin e Treguesve të Tregut;
- f. Kërkesat për dokumentacion;
- g. Rregullat korresponduese dhe
- h. Marrëveshjet e cmimit në avancë:

Sqarohen në Udhëzimin specifik të Ministrit të Financave në lidhje me taksimin ndërkombëtar.

40. Të ardhurat dhe llogaritja e tatimit të pagueshëm mbi të ardhurat e korporatave

40.1 Tatimi mbi fitimin korporativ deklarohet nga tatimpaguesit në bazë vjetore. Për veprimtarinë ekonomike të ushtruar në një vit të plotë tatimor, 1 janar deri 31 dhjetor, deklarimi i fitimit të tatueshëm bëhet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

40.2 Në rastet kur tatimpaguesi mbyll veprimtarinë ekonomike gjatë vitit, deklarimi i fitimit të tatueshëm mund të bëhet në cdo periudhë të vitit dhe përfshin veprimtarinë ekonomike të periudhës para deklarimit.

40.3 Për llogaritjen e detyrimit të tatimit mbi fitimin, zbatohet norma e tatimit në fuqi. Tatimi i fitimit i llogaritur sipas dispozitave të Ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" është i detyrueshëm për tu paguar. Detyrimi i tatimit mbi fitimin që duhet të paguhet reduktohet me:

- a. Tatimin e huaj të paguar, por brenda kriterëve dhe kufizimeve të Nenit 42 "Kreditimi i tatimit të huaj për tatimin mbi të ardhurat nga korporatat";
- b. Ndonjë tatim që ka paguar korporata sipas kreut 5 të Ligjit, dhe i cili i është mbajtur në burim nga paguesi i të ardhurave. Shembull, nëse entiteti "A" ka marrë pagesë nga entiteti "B" në lidhje me një të drejtë autori të dhënë, dhe entiteti "B" nga pagesa sipas kontratës për 1.000.000 lekë, ka mbajtur tatimin në burim 15 % pra 150.000 lekë, kjo shumë e paguar si tatim, është e kreditueshme nga detyrimi i tatimit mbi fitimin korporativ për entitetin "A";
- c. Parapagimet e tatimit mbi fitimin të bëra nga entiteti sipas parashikimeve të nenit përkatës të Ligjit.

40.4 Shuma e detyrimit tatimor të tatimit mbi fitimin korporativ që rezulton pasi nga tatimi mbi fitimin e llogaritur zbriten pagesat e mësipërme, përben shumën që duhet paguar të detyrimit.

41. Norma tatimore

41.1 Norma standarte e tatimit mbi të ardhurat e korporatës në Shqipëri është 15 %.

41.2 Normat e ndryshme nga norma standarde që mund të aplikohen në menyrë të vazhdueshme apo përkohësisht për sektorë dhe industri të caktuara, duhet të jenë të përcaktuara në këtë ligj apo ligje të tjera me natyrë fiskale si: Ligji “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve”; Ligji “Për zonat e Zhvillimit teknologjik” Ligji “Për inkubatorët e IT

42. Kreditimi i tatimit të huaj për tatimin mbi të ardhurat nga korporatat

42.1 Entitetet rezidente në Republikën e Shqipërisë, gëzojnë të drejtën e kreditimit të tatimit të huaj të paguar, dhe që lidhen me seli të përhershme që këto entitete mund të kenë krijuar në juridiksione tatimore të tjera jashtë Shqipërisë, dhe të cilave duhet t’u atribuohen fitimet e realizuara në këto vende.

42.2 Shembull 1:

Në vitin 2023, një entitet rezident shqiptar, ushtron veprimtari ekonomike në Shqipëri, por ka krijuar një seli të përhershme si Filial edhe në Itali. Nga veprimtaria në këto dy seli të përhershme, entiteti ka realizuar fitim neto si më poshtë:

- nga veprimtaria në Shqipëri: 30.000.000 lekë
- nga veprimtaria në Itali: 16.000.000 lekë

Ky entitet, duke qënë rezident tatimor shqiptar, i nënshtrohet tatimit në Shqipëri mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pra detyrimi tatimor në Shqipëri do të jetë:

- fitimi në total: $30.000.000 + 16.000.000 = 346.000.000$ lekë
- tatimi mbi fitimin korporativ: $46.000.000 \times 15\% = 6.900.000$ lekë

Në lidhje me fitimin e realizuar në Itali, fitim i cili i atribuohet selisë së përhershme të krijuar në Itali dhe që normalisht tatóhet në Itali, ky entitet ka detyrimin e pagimit në Itali të tatimit mbi fitimin si jorezident, por që ka krijuar një seli të përhershme. Supozojmë që norma e tatimit në Itali është 36 % mbi fitimin neto. Pra, tatimi i paguar në Itali:

$16.000.000 \times 36\% = 5.760.000$ lekë

Tatimpaguesi i ka përcjellë Administratës Tatimore dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Ndërkohë, entiteti shqiptar bën reduktimin e tatimit si më poshtë:

Tatimi mbi fitimin korporativ që duhej të paguhej sikur të ardhurat e realizuara në Itali të realizoheshin në Shqipëri:

$16.000.000 \times 15\% = 2.400.000$ lekë. Vetëm për këtë shumë do të bëhet reduktimi i tatimit të pagueshëm në Shqipëri.

$6.900.000 - 2.400.000 = 4.500.000$ lekë, do jetë detyrimi përfundimtar i tatim mbi fitimin korporativ i pagueshëm në Shqipëri

42.3 Shembull 2.

Supozojmë se një entitet ka një Degë për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike në Maqedoninë e Veriut, ku tarifa në fuqi e tatimit mbi fitimin korporativ është 10%. Në këtë rast do të kishim:

- fitimi i realizuar në Shqipëri: 10.000.000 lekë
- fitimi i realizuar në Maqedoninë e Veriut: 6.000.000 lekë

Detyrimi i tatimit mbi fitimin korporativ që duhet të deklarohet: $10.000.000 + 16.000.000 = 16.000.000 \times 15\% = 2.400.000$ lekë

Për fitimin që ka realizuar në Maqedoninë e Veriut, entiteti është tatuar atje me tarifën 10%, pra $6.000.000 \times 10\% = 600.000$ lekë.

Në këtë rast, meqenëse tatimi i paguar në Maqedoni (10%) nuk e kalon tatimin e pagueshëm për ato të ardhura në Shqipëri (15%), tatimi mbi fitimin korporativ i pagueshëm në Shqipëri do të reduktohet vetëm për tatimin e paguar në Maqedoninë e Veriut për 600.000 lekë.

$2.400.000 - 600.000 = 1.800.000$ lekë, do jetë detyrimi përfundimtar për tu paguar i tatim mbi fitimin korporativ që entiteti do paguajë në Shqipëri.

42.4 Kreditimi (reduktimi) i tatimit mbi fitimin korporativ i paguar jashtë Shqipërisë, për fitimet e realizuara jo në Shqipëri, në asnjë rast, nuk duhet të kalojë tatimin e pagueshëm në Shqipëri, por mund të jetë më i vogël ose i barabartë me tatimin e pagueshëm në Shqipëri, nëse ato fitime do të realizoheshin në Shqipëri.

42.5 I njëjti parim në lidhje me kreditimin e tatimit të huaj, vlen edhe për personat fizikë, përfshirë inddividët, të vetpunësuarit dhe tregtarët, nëse ata kanë të ardhura me burim jashtë Shqipërisë.

42.6 Në këtë rast, pasi nga tatimpaguesi të jetë marrë dokumentacioni i plotë që ka realizuar të ardhurat dhe ka paguar tatimin në Maqedoni në këtë shumë, kreditimi i tatimit do të bëhet si më poshtë:

42.7 Shuma e tatimit të huaj të paguar vërtetohet me dokumentacionin përkatës:

- a. Dokumentin e regjistrimit të selisë së përhershme në vendin e huaj (TIN-in përkatës etj);
- b. Kopje të deklaratës tatimore të dorëzuar në vendin ku ka krijuar selinë e përhershme;
- c. Dokumentacionin justifikues bankar të pagesës së detyrimit për tatimin mbi fitimin korporativ/tatimit mbi të ardhurat personale në vendin përkatës.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI PËRCAKTIMIN E FITIMIT

43. Fitimi i Tatueshëm

43.1 Fitimi i tatueshëm llogaritet si diferencë e të ardhurave me shpenzimet e zbritshme të biznesit. Të ardhurat përfshijnë cdo të ardhur biznesi të realizuar, pavarësisht nga natyra e saj. Pasqyrimi i shpenzimeve për efekt tatimi, merr në konsideratë kufizimet sipas këtij ligji në lidhje me shpenzimet e kryera nga biznesi, por të cilat konsiderohen pjesërisht apo tërësisht jo të zbritshme.

43.2 Ndërtimi i Deklaratës së fitimit të tatueshëm, nisur nga të dhënat, regjistrimet dhe pasqyrat që mban tatimpaguesi, në zbatim të detyrimeve që ka bazuar në ligjin "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe nga aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

43.3 Në çdo rast, për llogari të Deklaratës së tatimit mbi fitimin korporativ, merrën në konsideratë si prioritare përcaktimet në legjislacionin tatimor, pavarësisht nga trajtime të ndryshme që mund të japin Standardet e Kontabilitetit apo vetë ligji "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

44. Parimi i tregut.

Procedurat dhe standartet që zbatohen për të garantuar që transaksionet ndërmjet palëve të lidhura, të jenë në përputhje me parimin e tregut, përcaktohen në Udhëzimin specifik të Ministrit përgjegjës për Financat.

45. Kontratat afatgjata

45.1 Kontratat afatgjata përfshijnë zakonisht veprimtari ekonomike në fushën e realizimit të një projekti për të cilin ndërmjet porositësit dhe sipërmarrësit lidhen kontrata furnizimi me mallra apo shërbime për një periudhë mbi 12 muaj dhe që kryesisht realizohen në fushën e ndërtimeve, montimeve, prodhimit të komponentëve të investimit apo shërbimeve të lidhura me këto kontrata:

45.2 Për këto lloje kontratash, duhet që të harmonizohen periudha tatimore kur alokohen shpenzimet e kryera për realizimin e të ardhurave të marra. Të ardhurat që lidhen me një kontratë afatgjatë dhe që duhet të njihen dhe të pasqyrohen në Deklaratën e fitimit të tatueshëm, i korrespondojnë pjesës së kontratës së përfunduar në vitin tatimor përkatës.

45.3 Përqindja e përfundimit përcaktohet në dy mënyra, në vartësi të metodës që zgjedh tatimpaguesi:

- a. ose duke iu referuar raportit të kostove të atij viti me shpenzimet e përgjithshme të vlerësuara dhe të preventivuara
- b. ose duke iu referuar standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontabilitetit.

45.4 Shpenzimet e zbritshme tatimore që lidhen me kontratat afatgjata merren parasysh në vitin tatimor në të cilën ato kryhen, në përputhje me standartet e kontabilitetit.

46. Rregullat e zbatueshme mbi riorganizimet e Biznesit

46.1 Ndryshimet në strukturën e entitetit, të tilla si bashkimet, ndarjet, ndarjet e pjeshme, shkëmbimi i aksioneve dhe transferimet e degëve të veprimtarisë, janë brenda konceptit të riorganizimit të biznesit.

46.2 Në lidhje me aktivet që transferohen, në rastet e riorganizimit të biznesit, nuk duhet të llogariten fitime të supozuara kapitale, objekti i tatimit. Këtu bëjnë përjashtim pagesat në para e cila tejkalojnë pagesën e cilësuar në të holla..

47. Tatimi i llogaritur për transferimin e aktiveve të biznesit

47.1 Transferimi i aktiveve të biznesit konsiderohet i tatueshëm në rastet e mëposhtme:

- a. një tatimpagues rezident transferon aktivet e biznesit nga zyra qendrore e tij vendase në një seli të përhershme jashtë vendit dhe Republika e Shqipërisë nuk ka më të drejtë të tatojë aktivet e transferuara të biznesit për shkak të transferimit;
- b. një tatimpagues rezident transferon rezidencën e tij tatimore në një vend tjetër, me përjashtim të atyre aktiveve të biznesit që mbeten efektivisht të lidhura me një seli të përhershme në Republikën e Shqipërisë.

47.2 Baza e tatueshme që do t'i nënshtrohet tatimit është shuma e barabartë me vlerën e tregut të aktiveve të transferuara të biznesit minus vlerën e tyre për qëllime tatimore, në momentin e daljes së aktiveve të biznesit.

48. Shpenzimet e Zbritshme

48.1 Për qëllime të llogaritjes së tatimit mbi fitimin korporativ, shpenzimet e biznesit, konsiderohen të zbritshme nga të ardhurat, nese plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a. Nuk janë subjekt i kufizimeve të parashikuara në nenin 50 të këtij ligji;
- b. Janë shpenzime reale të kryera në interes të drejtpërdrejtë të veprimtarisë ekonomike;
- c. Janë shpenzime të lidhura me drejtimin e nevojshëm dhe normal të veprimtarisë së tatimpaguesit;
- d. Janë shpenzime të kryera me qëllim realizimin dhe garantimin e fitimit, ruajtjen e aktiveve dhe kapitalit si burim për gjenerimin e të ardhurave, apo shpenzime për të siguruar në kohën e duhur riformimin apo zëvendësimin e kapitalit, si shpenzimet e amortizimit;
- e. Të jenë përballuar apo që do përballohen nga aktivet e tatimpaguesit;
- f. Të jenë pasqyruar në kontabilitetin e tatimpaguesit;
- g. Të provohen nga tatimpaguesit me dokumentacionin e nevojshëm ligjor:
 - i. Faturë elektronike, sipas përcaktimeve në legjislacionin tatimor për fiskalizimin, për TVSH-në dhe procedurat tatimore, në lidhje me transaksionet biznes me biznes.
 - ii. Dokument i njohur ligjor për rastet kur bëhen pagesa në formën e tarifave të shërbimit në interes të biznesit, për ente publike apo organizma të tjetë juridikë të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- h. Një shpenzim i konsideruar nga tatimpaguesi si i zbritshëm, pretendohet si i tillë nisur nga fakti se është i pasqyruar në një faturë të rregullt elektronike nga pikpamja formale, nuk con automatikisht në konsiderimin e tij si i zbritshëm, pasi, shpenzimi duhet të jetë transaksion real i kryer dhe që përfaqëson një furnizim real malli apo shërbimi, pra nuk është një transaksion fiktiv për të cilin është lëshuar një faturë elektronike.

49. Shpenzime të Zbritshme për Tokën që Shkëmbehet për Ndërtim

49.1 Për sektorin e ndërtimit, metodologjia për njohjen e të ardhurave nga shitja dhe shpenzimeve të veprimtarisë, si dhe konsiderimi i pjesës përfituese të pronarëve të truallit dhe vetë kostove të truallit, janë përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.

49.2 Sipërmarrjet që operojnë në ndërtimin dhe/ose shitjen e ndërtesave për qëllime strehimi, veprimtari prodhuese, tregtare ose veprimtari të shërbimit, pasqyrojnë si të ardhura: të ardhurat nga veprimtaria e sipërmarrjes, nëse janë vetëm sipërmarrës në ndërtim, të ardhurat nga shitja, apo dhënia me qera e objekteve nëse janë njëkohësisht ndërtues dhe posedues të objekteve të ndërtimit. Për përcaktimin e të ardhurave nga procesi i ndërtimit dhe nga shitja, merren në konsideratë:

- a. kostot dhe fitimi i deklaruar në situacionet e punimeve për sipërmarrësit;
- b. kontratat e shitjes së pasurive të paluajtshme dhe cmimet e reflektuara në to;
- c. të dhëna të deklaruara nga agjencitë imobilare, kompanitë ndërtuese apo investuese në lidhje me cmimet e shitjes së produkteve të ndërtimit;
- d. cmimet referuese në fuqi për m² të produktit të ndërtimit sipas destinacionit të përdorimit dhe sipas akteve nënligjore në fuqi;
- e. cmimet referuese të qeradhënies sipas akteve nënligjore në fuqi.

49.3 Shpenzimet në sektorin e ndërtimit përfshijnë shpenzimet e situacionuara të procesit të ndërtimit, si dhe shpenzimet e tjera të zbritshme që bëhen gjatë fazave të projektimit, zbatimit dhe shitjes së produktit të ndërtimit.

50. Shpenzimet jo të Zbritshme dhe kufizimi i Zbritjes

50.1 Shpenzimet e biznesit të listuara në nenin 50 të ligjit nuk zbriten nga fitimi i tatueshëm:

- a. Kostot e blerjes, kostot e përmirësimit dhe shpenzime të tjera të bëra në funksion të përmirësimit të tokës, truallit apo shesheve të ndërtimit nuk janë shpenzime të zbritshme të biznesit. Këto kosto nuk janë të zbritshme nga të ardhurat, qoftë si kosto të vitit kur ndodhin, qoftë si kosto të amortizueshme për disa periudha;
- b. Kostot e blerjes, përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të amortizueshme. Kosto të tilla përfshijnë shpenzimet që kryhen brenda një viti dhe që kanë për qëllim përmirësimin e kapacitetit përfitues të ardhshëm të aktiveve dhe kur kosto të tilla kalojnë 15 % të vlerës së mbetur të aktivitetit (vlerë fillestare minus amortizim i akumuluar). Nëse këto kosto të kryera brenda një viti, nuk tejkalojnë 15 % të vlerës së mbetur të aktivitetit, konsiderohen shpenzime korrente të periudhës;
- c. Amortizimi i aktiveve afatgjata shpërndahet si shpenzim i periudhave vjetore, bazuar në normat e amortizimit, vitet dhe rregullat e tjera të nenit 51 të Ligjit. Asnjë aktiv afatgjatë nuk konsiderohet shpenzim i menjehershëm i zbritshëm në vitin e blerjes apo krijimit, përveçse kur në Ligj përcaktohet ndryshe;
- d. Zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë apo kapitalit kontribues në një partneritet prek llogaritë e bilancit duke reflektuar rritjen e aseteve në aktiv dhe të kapitalit/kontributit në pasiv dhe nuk prek llogaritë e shpenzimeve;
- e. Dividendët e llogaritur/shpërndarë për aksionerët ose ortakët, si dhe dividendët e entiteteve të tjera sipas Ligjit, sepse janë elementë që llogariten pasi janë deklaruar të ardhurat, shpenzimet, fitimi dhe tatimi mbi fitimin korporativ;

- f. Interesat e paguara nga tatimpaguesi, të cilat tejkalojnë normën mesatare të interesit 12 mujor të kredisë vjetore të interesit të tregut të vendosur nga bankat komerciale, siç publikohet zyrtarisht nga Banka e Shqipërisë. Nga ky rregull përjashtohen interesat e paguara për kreditë e dhëna nga institucionet e mikrokredisë, të cilat konsiderohet totalisht të zbritshme. Në institucionet e Mikrokredisë bëjnë pjesë
- g. Dënimet administrative përfshirë gjobat, kamatvonesat apo dënimet e tjera që tatimpaguesi i paguan një autoriteti për shkelje të legjislacionit të fushës, si dhe kushtet penale apo dënimet që një tatimpagues paguan apo duhet të paguajë për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale me tatimpagues të tjerë;
- h. Krijimi i rezervave dhe fondeve të tjerë speciale, si dhe krijimi apo rritja e provigjioneve. Rezervat ligjore dhe rezervat e tjera krijohen nga fitimi pas tatimit. Provigjonet për rreziqe që mund të krijojë tatimpaguesi nuk alokohen në shpenzimet e zbritshme, dhe në rastet kur tatimpaguesi i ka pasqyruar ato si shpenzime jo të zbritshme, i rimerr ato, të ardhurat nga rimarrja nuk pasqyrohen si të ardhura të tatueshme. Përjashtohen nga rregulli i mësipërm rastet e parashikuara në Ligj që lidhen me veprimtaritë e sigurimit dhe risigurimit, si dhe me veprimtaritë e institucioneve bankare apo institucioneve të tjera financiare;
- i. Tatimi mbi fitimin korporativ, TVSH-ja e kreditueshme, si dhe akciza e llogaritur nga subjektet që llogarisin akcizë;
- i. Në rastet kur tatimpaguesit janë subjekt i TVSH-së dhe kanë të drejtë të kreditojnë TVSH-në e paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, TVSH-ja e paguar nuk është pjesë e kostos së mallrave dhe shërbimeve të blera dhe nuk pasqyrohet si shpenzim. Nëse tatimpaguesi nuk gëzon të drejtën e kreditit të TVSH-së të paguar në blerjen e mallrave dhe shërbimeve, vlera e mallit apo shërbimit të blerë, përfshirë TVSH-në konsiderohet shpenzim i zbritshëm.
 - ii. Tatimpaguesit që prodhojnë mallra të tatueshme me akcizë si prodhuesit e karburanteve, pijeve alkoolike, birrës etj, akcizën e llogaritur nuk e kanë pjesë të kostos së mallit të shitur dhe nuk e pasqyrojnë si shpenzim. Tatimpaguesit që importojnë mallra të tatueshme me akcizë, akcizën e paguar në import për mallrat e importuara, e kanë pjesë të kostos së mallit të blerë, kosto të cilën e transferojnë në cmimin e mallrave për shitje. Cdo tatimpagues tjetër, i cili, për nevoja të biznesit blen mallra me akcizë, të llogaritur nga prodhuesi vendas apo të paguar në import, kosto e mallit të blerë, përfshirë akcizën si pjesë të tij, është shpenzim i zbritshëm.
 - iii. Në rastet kur një tatimpagues, në rolin e agentit tatimor, mban tatimin në burim për përfituesin e të ardhurave që ka furnizuar shërbimin, konsideron shpenzim të zbritshëm shumën bruto të faturës së paguar, ndërkohë që tatimi i mbajtur për furnizuesin e shërbimit nuk është shpenzim i zbritshëm.
- j. Shpenzimet për pritje-përcjellje që tejkalojnë kufirin 0,3 për qind të të ardhurave vjetore për të gjithë tatimpaguesit;

Shpenzimet që tejkalojnë kufirin 3 % të shpenzimeve gjithsej të dokumentuara, të kryera për pjesëmarrje, prezantim në panairë apo ekspozita jashtë vendit, për tatimpaguesit eksportues,

përfshirë prodhuesit me material porositësi, të cilët në 3 vitet e fundit kanë realizuar mbi 70 për qind të të ardhurave nga eksporti.

Në shpenzimet e përfaqesimit përfshihen shpenzime të dokumentuara me karakter të përgjithshëm që një shoqëri bën për prezantimin e produkteve apo shërbimeve të saj në marrëdhëniet me partnerët e biznesit apo klientët, jashtë apo brenda vendit, të tilla si shpenzimet për organizimin e takimeve të biznesit, pjesëmarrjen në panaire, prezantimin e projekteve apo produkteve të reja, përurimin e investimeve të kryera etj të kësaj natyre.

k. Shpenzimet e kryera si konsum personal nga aksionerët, ortakët, administratorët dhe familjarët e tyre. Shpenzime të tilla personale nuk përballohen nga mjetet dhe aktivet e tjera të tatimpaguesit. Shembuj: ushqimi, akomodimi, karburanti, udhëtimet private, pagesa qeraje, pagesa blerje shtepie, pagesa argëtimi, pagesa për kujdes shëndetsor apo estetik, pagesa pajtimi telefonik privat e të tjera të kësaj natyre, pagesa për defrim, pagesa për akomodim, qera apo shpenzime të tjera të punonjësve jo pjesë e listëpagesës së tatimpaguesit, pavarësisht termave të kontratës me furnizuesin e mallrave apo shërbimeve ku janë të punësuar këta punonjës, si dhe cdo pagesë apo shpenzim tjetër që ka natyrë konsumi personal dhe që nuk është shpenzim i lidhur dhe që ndikon në rritjen apo ruajtjen e të ardhurave dhe fitimit të tatimpaguesit;

l. Shpenzimet të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me ligj apo me akte nënligjore;

1. Kufizimi i dietave. Përfitimet e punonjësve të cilët, për nevoja pune të tatimpaguesi, dërgohen me shërbim jashtë vendit efektiv të punës kufizohen në:

- i. Akomodimi brenda vendi, deri 6.000 lekë dita
- ii. Akomodimi jashtë vendit, deri 150 euro dita
- iii. Pagesa e dietës për ushqim për shërbimet brenda vendit, deri 4.000 lekë dita dhe 2.000 lekë pjesa jo e plotë e ditës
- iv. Pagesa e dietës për ushqim për shërbimet jashtë vendit, deri 80 euro dita dhe 40 europjesa jo e plotë e ditës
- v. Pagesa për udhëtim brenda vendi, jo më tepër se çmimi i biletave të miratuara për transportin publik
- vi. Pagesa për udhëtim jashtë vendit, paraqitet fatura dhe pagesa e biletës së transportit ajror, detar, hekurudhor apo automobilistik

m. Dhuratat dhe donacionet që mund të bëjë tatimpaguesi, me përjashtim të dhuratave në formë simbolike, por brenda kufijve të lejuar në paragrafin “j” të nenit 50 të Ligjit;

n. Faturat e shpenzimeve për shërbime teknike, konsulence dhe të menaxhimit të faturuara nga jo-rezidentë, në qoftë se këto fatura nuk paguhen nga tatimpaguesi dhe tatimi i mbajtur në burim nuk transferohet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit të shtetit brenda afatit të dorëzimit të deklaratës tatimore vjetore. Në rast se shpenzime të tilla paguhen më vonë, ato janë të zbritshme në vitin tatimor kur ato paguhen, por jo kur paguhen më vonë se muaji dhjetor i vitit pasardhës të vitit të lëshimit të faturës;

o. shpenzimet për pagat, shpërblimet dhe forma të tjera të të ardhurave personale që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës, të paguara të punësuarve, duke përfshirë administratorët dhe që nuk janë bërë nëpërmjet sistemit bankar;

- p. Shpenzimet që lidhen me shumata e paguara në CASH, dhe që tejkalojnë kufijtë e përcaktuar nga dispozitat e ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
- q. Shpenzimet e sigurimit të jetës dhe shëndetit të punonjësve të tatimpaguesit që tejkalojnë 5% të pagave bruto të tyre për vitin tatimor. Shpenzime të tilla brenda kufirit të lejuar dokumentohen me kontratën ndërmjet tatimpaguesit dhe kompanisë së sigurimeve, si dhe me policat e sigurimit për çdo punonjës;
- r. Shpenzimet për financimin nëpërmjet bursave të studimeve brenda dhe jashtë vendit, dhe që jepen për nxënësit dhe studentët me kushtin që përfituesit e këtyre bursave të mos jenë familjarë apo persona të lidhur me aksionerët, ortakët, administratorët dhe drejtuesit e tjerë të kompanisë;
- s. Shpenzimet për kontributet e bëra nga punëdhënësi në emër të punonjësve të tij në një plan pensioni privat, që tejkalojnë kufizimet e paragrafit 5 të nenit 20 të Ligjit. Shpenzime të tilla brenda kufirit të lejuar dokumentohen me kontratën ndërmjet tatimpaguesit dhe Fondit Privat të Pensioneve, si dhe me pagesat e bëra për çdo punonjës në bazë të skemës;
- t. Shpenzimet të cilat janë të lidhura me gjenerimin e të ardhurave, por të cilat nuk janë përfshirë në fitimin e tatueshëm të këtij viti. Shpenzime të tilla duhet të konsiderohen si shpenzime të parapaguara dhe do alokohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në atë periudhë kur janë deklaruar të ardhurat e gjeneruara si rezultat i këtyre shpenzimeve;
- u. Mëdhënia dhe ryshfetet të cilat mund të jenë pasqyruar në dokumentacionin e tatimpaguesit, pavarësisht adresimit sipas Kodit Penal;
- v. Shpenzimet e kryera për veprimtari sponsorizuese që tejkalojnë kufijtë e mëposhtëm:
 - i. deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit për botuesit e shtypit dhe botimet e veprave letrare, shkencore, enciklopedike, si dhe për veprimtaritë kulturore apo artistike.
 - ii. deri në masën 5 për qind të fitimit para tatimit për veprimtaritë sportive. Shumat e sponsorizuara, brenda kufirit të mësipërm për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, për efekt të përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme nuk lejohet. Kjo zbritje lejohet pas lëshimit të “Autorizimit të sponsorizimit” nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Paragrafi “ii” zbatohet vetëm për entitetet sponsorizuese, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë.
 - iii. deri në masën 3 për qind të fitimit para tatimit për sponsorizimet e veprimtarive të tjera që nuk përfshihen në paragrafet “i” dhe “ii” më sipër.

Për tatimpaguesit, të cilët realizojnë fitim vjetor të tatueshëm mbi 100 milionë lekë, shumata e sponsorizuara për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive, të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës, të cilat janë brenda kufirit 5 % të fitimit para tatimit për efekt të përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin e periudhës tatimore, këto sponsorizime janë të zbritshme sa trefishi i vlerës së shumës së sponsorizuar. Mbartja e tyre në periudhat tatimore të ardhshme nuk lejohet.

Shembull

Një tatimpagues ka rezultuar me fitim të tatueshëm para tatimit 1.000.000.000 lekë.

*Shpenzimet e sponsorizimit për atë vit financiar janë 40.000.000 lekë, pra 4 % të fitimit para tatimit e cila është më pak se norma e lejuar e sponsorizimit prej 5 % e fitimit para tatimit. Për llogaritjen e tatimit mbi fitimin, shuma e sponsorizuar 40.000.000 lekë do të njihet si shpenzim i zbritshëm sa trefishi i saj, pra 120.000.000 lekë. Tatim mbi fitimin korporativ i llogaritur për t'u paguar është 132.000.000 lekë $(1.000.000.000 - 120.000.000 \text{ leke}) * 15\%$.*

Për të përfituar njohjen si shpenzime të zbritshme sa trefishi i shumës së sponsorizuar, tatimpaguesi duhet të disponojë “Autorizimin e sponsorizimit” të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për lëshimin e autorizimit nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve zbatohet procedura e mëposhtme:

Autorizimi i Sponsorizimit jepet për sponsorizimet që kryhen për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi i fushës dhe cdo ekip sportiv duhet të vërtetojë se është pjesë e federatave sportive të njohura sipas legjislacionit në fuqi “Për sportin, në mënyrë që të mund të jetë subjekt i një sponsorizimi të tillë nga tatimpaguesit.

Dokumentacioni që paraqet tatimpaguesi sponsorizues në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për tu pajisur me Autorizimin e sponsorizimit përmban:

Për përfituesin e sponsorizimit duhet të ofrohet dokumentacion që verteton se:

- ai merr pjesë ose ka të drejtë të konkurrojë në nivel amator ose profesionist sipas përcaktimit në ligjin nr. 79/2017 datë 27.04.2017 “Për sportin” dhe që është pjesë e federative sportive;
- ushtron veprimtarinë sipas legjislacionit në fuqi për sportet, prej të paktën 1 viti;
- nuk ka detyrime tatimore të papaguara;
- nuk ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale në fushën e evazionit fiskal, mospagimit të detyrimeve tatimore apo falsifikimit të dokumenteve;
- ka përmbushur të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore;
- nuk është objekt i procedurave të falimentimit dhe/ose likuidimit apo ndonjë procedure tjetër të ngjashme;
- nuk është pezulluar me vendim gjykate.

Për tatimpaguesin sponsorizues paraqitet:

- një deklaratë në të cilën angazhohet të japë sponsorizim për ekipin sportiv pjesë e federatës sportive që kërkon mbështetje financiare;
- kontrata e sponsorizimit midis sponsorizuesit dhe përfituesit;
- dokumentacioni bankar ku vërtetohet shuma e sponsorizimit të transferuar në llogarinë bankare të të sponsorizuarit;

Dokumentacion shtesë që shoqëron kërkesën e tatimpaguesit sponsorizues dhe të subjektit të

sponsorizuar:

- Sponsorizuesi dhe i sponsorizuari paraqesin një program mbi zhvillimin e sportit në të cilin parashikohen: nevojat për sponsorizim, përdorimi i fondeve të sponsorizimit gjatë vitit (duke evidentuar fondet që do të përdoren për zhvillimin, përmirësimin dhe rinovimin e infrastrukturës sportive evidentimin e talenteve dhe nevojat për trajnim, mbulimin e shpenzimeve që rrjedhin nga organizimi i garave sportive), si dhe përfitimet që parashikohen të vijnë nga ky sponsorizim;
- Deklaratën e të sponsorizuarit dhe sponsorizuesit, me anë të së cilës garantojnë vërtetësinë e të dhënave të dokumenteve dhe deklarimeve të paraqitura në aplikim;
- Autorizimin me shkrim nga sponsorizuesi dhe i sponsorizuari, që pranojnë autoritetin e organit tatimor për të kryer të gjitha verifikimet dhe kontrollet e nevojshme dhe në çdo kohë me qëllim garantimin e ligjit dhe të rregullave të përcaktuara në legjislacionin tatimor dhe atë mbi sponsorizimet;
- Vetëdeklarimet se sponsorizuesi dhe i sponsorizuari nuk janë në një situatë apo rrethanë të konfliktit të interesit.

Dokumentacioni dhe/ose vërtetimet e kërkuara më sipër paraqiten në format origjinal ose kopje të noterizuara provuese të dokumentacionit të kërkuar.

Dhënia e “Autorizimit të sponsorizimit”

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve shqyrton dokumentacionin e paraqitur brenda 30 ditëve nga paraqitja e të dhënave të plota të kërkuara. Pas shqyrtimit të dokumentacionit ai vendos miratimin apo refuzimin e Autorizimit të sponsorizimit”.

Aplikimi për marrjen e “Autorizimit të sponsorizimit” refuzohet nëse:

- Vërtetohet se aplikuesit nuk plotësojnë të gjithë kërkesat sipas procedurës së përcaktuar në këtë Udhëzim; ose
- Nga verifikimet dhe kontrollet të cilat mund të kryhen në çdo kohë tek sponsorizuesi dhe i sponsorizuari, vërtetohet se palët kanë paraqitur informacione, të dhëna apo dokumentacione të pavërteta apo të deformuara në lidhje me kërkesat e procedurës

Njohja si shpenzim i zbritshëm zbatohet pas lëshimit të “Autorizimit të sponsorizimit” nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, procedurë e cila nuk duhet të zgjasë më shumë se 30 ditë kalendarike nga momenti i aplikimit.

- w. humbjet, dëmtimet, firot dhe skarcot gjatë prodhimit, tranzitimit, magazinimit, tregtimit, tej rregullave të përcaktuara në akte të veçanta ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi.
- Për mallrat mbi të cilat aplikohet akciza, firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë procesit të prodhimit, magazinimit, transportit dhe tregtimit, llogariten sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore të legjislacionit në fuqi për Akcizat;

- Për industrinë prodhuese, që përdorin lëndë djegëse në procesin teknologjik, normativat e lëndëve të para djegëse përcaktohen sipas VKM Nr.612, datë 5.9.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”;
- Për duhanin, firot dhe humbjet në procesin e përpunim-manipulimit përllogariten sipas dispozitave të VKM Nr. 687, datë 18.6.2009 “Për përcaktimin e nivelit të firove të lejuara gjatë procesit të përpunim-manipulimit të duhanit”;
- Për humbjet dhe firot në procesin e prodhimit, për të cilat nuk ka akte të veçanta ligjore dhe nënligjore, sasia dhe vlera e lejuar e tyre do të llogariten duke u bazuar në të dhënat e kartës apo skemës teknologjike të procesit të prodhimit në lidhje me këto firo apo dëmtime;
- Me përjashtim të mallrave të akcizës, të cilat mbulohen nga VKM Nr. 612, date 5.9.2012 “Për dispozitat zbatuese të ligjit “Për akcizat”, të ndryshuar”, për mallrat e tjerë nuk do të njihen firo gjatë transportit apo magazinimit;
- Për energjinë elektrike, humbje gjatë shpërndarjes do të konsiderohet përqindja e humbjeve e përcaktuar në VKM Nr.171, date 25.2.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”.

Tatimpaguesit të cilët pretendojnë se kanë firo apo humbje ligjore në procesin e tyre teknologjik, duhet të kenë të depozituar në Drejtorinë rajonale Tatimore, të dhënat dhe dokumentacionin argumentues për:

- (i) kartën teknologjike të linjës, impiantit etj;
- (ii) përshkrimin e procesit të prodhimit;
- (iii) planimetrinë e objektit;
- (iv) normativat e konsumit të lëndës së parë dhe të orëve të punës për njësi produkti të gatshëm (karta teknologjike e prodhimit);
- (v) lëndët e përdorura në procesin e prodhimit dhe fazat ku përdoret.

Nëse kërkohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi, kartat teknologjike, duhet të jetë e konfirmuara/çertifikuara nga një institucion i njohur, që ka aftësinë teknike të konfirmimit të kartave teknologjike, si: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Instituti i Materialeve të Ndërtimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, Drejtoria e Patentave dhe Markave, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, Inspektorati Shtetëror përgjegjës, si dhe çdo Institucion tjetër që mbikqyr fusha të caktuara të veprimtarisë dhe miraton/mbikqyr karta të ndryshme teknologjike.

Administrata tatimore, në kontrollet e thelluara që ushtron, analizon kartat apo skemat teknologjike të procesit të prodhimit, që shoqërojnë makineritë apo linjat përkatëse nga prodhuesi i tyre, si dhe kryejnë verifikimet lidhur me nivelin e humbjeve të pësuar gjatë procesit të prodhimit/përpunimit.

- x. çdo shpenzim i pretenduar, masa e të cilit nuk vërtetohet me dokumente nga tatimpaguesi, apo që dokumenti nuk përfaqëson një transaksion real të kryer nga ai, sipas parimit që përmbajtja prevalon mbi formën.

49.2 Dokumentacioni që justifikon një shpenzim të pretenduar të zbritshëm nga e ardhura, është ai i parashikuar në legjislacionin “Për fiskalizimin”.

49.3 Por në rastet kur megjithëse një shpenzim i pretenduar si i zbritshëm, justifikohet me faturë të leshuar nga një shitës mallrash apo shërbimesh, ai do konsiderohet shpenzim fiktiv jo i zbritshëm nëse jemi në kushtet e mëposhtme:

- Tatimpaguesi shitës nuk ushtron veprimtari ekonomike me mallra dhe shërbime të cilat janë faturuar për blerësin;
- Jemi në kushtet e një skeme mashtrimi “Carusel” të tregtimit të TVSH-së nëpërmjet faturave

51. Amortizimi

51.1 Për amortizimin e aktiveve afatgjata të Biznesit, përdoret metoda lineare për të gjitha grupet. Aktivët afatgjata të secilit grup amortizohen individualisht.

51.2 Baza mbi të cilën llogaritet amortizimi për çdo grup, është kosto e blerjes ose krijimit të aktivit, duke shtuar koston e rikonstruksionit të tij gjatë vitit tatimor. Shpenzimet e rikonstruksionit të aktivit në një vit, duhet të jenë më të larta se 20 % e koston së blerjes apo krijimit të aktivit, në mënyrë që të regjistrohen si shtesë e vlerës së aktivit dhe të amortizohen në vite. Nëse shpenzime të tilla janë më pak se 20 % e koston kumulative të blerjes apo krijimit të aktivit, konsiderohen si shpenzime operationale të vitit tatimor dhe deklarohen si shpenzime të zbritshme të kësaj periudhe.

51.3. Nëse një aktiv del jashtë përdorimit gjatë një viti tatimor, vlera kontabël e mbetur për qëllime tatimore është e zbritshme në atë vit, me kusht që të ardhurat e mundshme nga nxjerrja jashtë përdorimit të jenë përfshirë në fitimin e tatueshëm. Nxjerrja jashtë përdorimit nënkupton shitjen e tij, qoftë si aktiv, qoftë për skrap, apo edhe hedhjen si mbeturinë nëse lloji i aktivit është i tillë që nuk ka asnjë vlerë përdorimi qoftë edhe si mbeturinë apo skrap.

51.4 Rivlerësimet e aktiveve të Biznesit, të kryera nga ai në zbatim të Standardeve dhe parimeve të Kontabilitetit, apo në zbatim të ndonjë ligji në fuqi për rivlerësimin e pasurive të paluajtshme, nuk merren në konsideratë për efekt të bazës mbi të cilin llogaritet amortizimi

52. Vlerësimi i Inventarit

52.1 Për vlerësimin e inventarëve, përfshirë edhe inventarin në proces, tatimpaguesi mund të përdorë cilëndo nga metodat e vlerësimit të parashikuara nga legjislacioni i kontabilitetit. Por metoda që ai përdor për vlerësimin e tij duhet të jetë e vazhdueshme për jo më pak se 5 vjet.

52.2 Zhvlerësimet apo rivlerësimet e mundshme të inventarëve, aktiveve financiare dhe atyre jomateriale, pas njohjes fillestare të tyre sipas rregullave të kontabilitetit, nuk njihen për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm. Ky rregull zbatohet edhe për aktivet financiare dhe aktivet jomateriale.

53. Zbritjet e Borxhit të Keq

Me përjashtim të institucioneve financiare, përfshirë edhe shoqëritë e sigurimit, nëse një e ardhur me burim shitjen e mallrave apo shërbimeve, është regjistruar në kontabilitet si e tillë, por nuk bëhet i mundur arkëtimi i parave, tatimpaguesi e trajton si borxh të keq sipas përcaktimeve të nenit 53 të ligjit. Nëse debitori është palë e lidhur sipas përkufizimit në këtë

ligj, zbritja e borxhit të keq nuk lejohet. Zbritja lejohet nëse tatimpaguesi beson se borxhi nuk do të jetë tërësisht ose pjesërisht i likuiduar, ndërkohë që ai ka ndërmarrë hapat e nevojshme për mbledhjen e borxhit. Tatimpaguesi ka barrën e provës që të bindë administratën tatimore se ai i ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për mbledhjen e borxhit, përfshirë edhe angazhimin me kontratë të shoqërive private të mbledhjes së borxheve.

Tatimpaguesi e zbrit plotësisht shumën e këtij borxhi nëse verifikohet se ka ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme ligjore për arkëtimin e borxhit, por ka qënë i pasuksesshëm, dhe duke mos pasur asnjë shpresë arkëtimi, e ka fshirë si detyrim- borxh nga librat e tij kontabël. Ndërmarrja e të gjitha veprimeve nënkupton rezultatet e procesit gjyqësor, rezultatet e angazhimit të përmbauesve privatë apo masa dhe informacion tjetër që argumenton fshirjen e borxhit për tu mbledhur.

54. Mbartja e Humbjeve

1. Humbjet nga veprimtaria ekonomike, që rezultojnë në një vit të caktuar tatimor, mund të mbarten, pra të kompenzohen me fitimet e pesë viteve të ardhshme tatimore. Humbjet e deklaruara nga tatimpaguesi, të cilat administrata tatimore i ka audituar dhe ka konkluduar se nuk mund të mbarten, nuk duhet të mbarten nga tatimpaguesi. Akti administrative për moslejimin e mbartjes së humbjeve mund të pranohet nga vetë tatimpaguesi, në të kundërt kërkohet një Vendim i strukturave të Apelimit Administrativ dhe/ose Gjyqësor.

Shembull 1.

Million lekë					
Nr	Vitet	Fitimi/Humbja Tatimore	Humbja e lejuar per mbartje	Fitimi/Humbja e vitit pas mbartjes së humbjeve të kaluara	Fitimi i tatueshëm
1	2023	-10	-10	-10	0
2	2024	1	-1	0	0
3	2025	2	-2	0	0
4	2026	1	-1	0	0
5	2027	3	-3	0	0
6	2028	2	-2	0	0
7	2029	6	0	6	6

Në vitin 2029, humbja e mbetur nga viti 2023 -1 milion lekë (10-1-2-1-3-2) nuk mbartet pasi kanë kaluar 5 vite me fitim tatimor, fitimi I të cilave është kompensuar me humbjet e mbartura nga viti 2023. Në vitin 2029, fitimi tatimor 6 milion lekë do t'atohet sipas normës tatimore në fuqi.

Shembull 2

milion lekë						
Nr	Vitet	Fitimi/Humbja Tatimore	Humbja e lejuar per mbartje	Humbja e lejuar per mbartje	Fitimi/Humbja e vitit pas mbartjes së humbjeve të kaluara	Fitimi i tatueshëm
1	2023	-10	0		0	0

2	2024	1	-1 (2023)		0	0
3	2025	2	-2 (2023)		0	0
4	2026	1	-1 (2023)		0	0
5	2027	2	-2 (2023)		0	0
6	2028	-2		-2 (2028)	0	0
7	2029	8	-2 (2023)	-2 (2028)	6	6

Çdo humbje mund të mbartet dhe të zvogelojë fitimet tatimore të 5 viteve të ardhshme , duke u evidentuar veçmas humbja e çdo viti, me parimin “humbja me e hershme mbartet përpara humbjes së mëvonshme” Nëse një humbje nuk arrin të mbartet me fitimet e 5 viteve në vijim, pasi tatimpaguesi mund të rezultojë me humbje në ndonjë nga 5 vitet në vijim, mbartja e humbjes ndërpritet

2. Nëse tatimpaguesi deklaron humbje tatimore në një vit, por që mund të ketë edhe humbje të lejuara për të mbartur nga vitet e kaluara, dhe në këtë vit ndodh një ndryshim direkt apo indirekt në pronësi që tejkalon 50% të aksioneve, kuotave ose të drejtave të votës, nuk lejohet mbartja e humbjes së rezultuar në këtë vit apo e drejta e mbartjes së humbjeve të viteve të kaluara. Ky kufizim zbatohet në rastet kur ndryshimi i pronësisë shoqërohet me ndryshim të llojit të veprimtarisë që ushtronte dhe do të ushtrojë tatimpaguesi:

Shembull 1.

Një tatimpagues që ushtron veprimtari në prodhimin e tubove plastike, ka filluar investimet për këtë veprimtari ekonomike në vitin 2022. Veprimtaria ekonomike në vitin 2023 rezulton me humbje -4 milion lekë, ndërkohë që ka humbje të mbartur nga viti 2022 për -10 milion lekë. Në vitin 2023 ndodh një ndryshim në pronësinë e kësaj sipërmarrje, ndryshim i cili tejkalon 50% të aksioneve, kuotave ose të drejtave të votës. Por kjo sipërmarrje, në vitin 2023 si dhe në vitet në vijim, vazhdon të operojë në prodhimin e tubove plastike, rrjedhimisht, bazuar në paragrafin “2” të nenit 54 të Ligjit, tatimpaguesi do të vazhdojë të mbartë humbjet e vitit 2023 dhe ato të vitit 2022, sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 54.

Shembull 2.

Një tatimpagues që ushtron veprimtari në prodhimin e tubove plastike, ka filluar investimet për këtë veprimtari ekonomike në vitin 2022. Veprimtaria ekonomike në vitin 2023 rezulton me humbje -4 milion lekë, ndërkohë që ka humbje të mbartur nga viti 2022 për -10 milion lekë. Në vitin 2023 ndodh një ndryshim në pronësinë e kësaj sipërmarrje, ndryshim i cili tejkalon 50% të aksioneve, kuotave ose të drejtave të votës. Por kjo sipërmarrje, në vitin 2023 vendos që ta shesë linjën e prodhimit të tubove plastike dhe ta përdorë godinën ku zhvillohej kjo veprimtari për tregtim me shumicë të artikujve industrialë. Në këtë rast bazuar në paragrafin “2” të nenit 54 të Ligjit, tatimpaguesi nuk ka të drejtë të vazhdojë të mbartë humbjet e vitit 2023 dhe ato të vitit 2022, sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 54.

Shembull 3.

Një tatimpagues që ushtron veprimtari në prodhimin e tubove plastike, ka filluar investimet për këtë veprimtari ekonomike në vitin 2022. Veprimtaria ekonomike në vitin 2023 rezulton me humbje -4 milion lekë, ndërkohë që ka humbje të mbartur nga viti 2022 për -10 milion lekë. Në vitin 2023 ndodh një ndryshim në pronësinë e kësaj sipërmarrje, ndryshim i cili tejkalon 50% të aksioneve, kuotave ose të drejtave të votës. Por kjo sipërmarrje, në vitin 2023 vendos që ta shesë linjën e prodhimit të tubove plastike, dhe ta përdorë truallin për ndërtime. Në këtë rast bazuar në paragrafin “2” të nenit 54 të Ligjit, tatimpaguesi nuk ka të drejtë të vazhdojë të mbartë humbjet e vitit 2023 dhe ato të vitit 2022, sipas përcaktimeve të paragrafit 1 të nenit 54.

Humbjet që mund të transferohen nëse jemi në kushtet e riorganizimit të biznesit sipas dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit të fushës, kufizimet e paragrafit të dytë të nenit 54 nuk zbatohen. Në këto raste, humbjet e mbartura mund të përdoren nga shoqëria përthithëse, dhe të përdoren për të reduktuar fitimet e tatueshme gjatë periudhave tatimore të mbetura për vitet e ardhshme sipas paragrafit 1 të nenit 54 të Ligjit.

Shembull: nëse një tatimpagues ka mbartur humbjen e vitit 2023 në fitimet e viteve 2024 dhe 2025, ndërkohë që në vitin 2026 biznesi i këtij tatimpaguesi riorganizohet, humbja ende e pambartur e vitit 2023, mund të mbartet në kushtet e reja të riorganizimit edhe në fitimet e viteve 2026 deri 2028.

55. Tatimi i ndryshimit të pronësisë për sektorë të veçantë

55.1 Fitimet nga shitjet/transferimet indirekte të aseteve të vendosura në Shqipëri, apo të kuotave të kapitalit të lidhura me këto asete, të përfshira të paragrafin 1 të nenit 55 të Ligjit, janë subjekt i tatimit mbi fitimin kapital në Shqipëri. Shitje indirekte ndodh kur një shoqëri zotëron një aktiv/pasuri në Shqipëri, të cilën një pale e tretë dëshiron të blejë. Sidoqoftë, shoqëria nuk ia shet palës së tretë aktivin, por pala e tretë blen aksionet e shoqërisë që zotëron aktivin, dhe në këtë mënyrë blen “indirekt”aktivin. Aksionet e blera mund të jenë të shoqërisë që zotëron aktivin në Shqipëri, apo edhe të shoqërive të tjera që kanë aksione në mënyrë direkte ose indirekte në shoqërinë që zotëron aktivin në Shqipëri. Zakonisht ka një zinxhir shoqërisht të ndërthurura ndërmjet asetit/pasurisë së vendosur në Shqipëri dhe pronarit përfundimtar indirekt, ndërkohë që shitja mund të ndodhë në cilëndo nga lidhjet në zinxhirin e aksionerëve.

55.2 Personi juridik që mban aktivin në Shqipëri konsiderohet si përfitues i të ardhurave nga shitja e aksioneve/kuotave/të drejtave, të ardhura këto të barabarta me vlerën e tregut të pjesës së aktivit të trajtuar si të transferuar. Vlera e tregut e një aktivi është ajo që pala e tretë do të marrë parasysh gjatë negociimit të kushteve të shitjes së aksioneve që shkakton ndryshimin e pronësisë. Njohja e kushteve të shitjes së aksioneve ndihmon në përcaktimin e vlerës së tregut të një aktivi të trajtuar si të shitur. Gjithashtu, metoda të tjera relevante të përcaktimit të vlerës së tregut mund të përdoren. Shuma e të ardhurave të trajtuara si të marra nga shitja do të zvogëlohet më pas nga kostoja/vlera në blerje proporcionale e aktivit, duke përcaktuar fitimin ose humbjen për shitjen e vlerësuar të aktivit. Fitimi i rezultuar do të përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit që mbante aktivin në vitin në të cilin ndodh transferimi i aktivit. Ndërsa humbja që mund të rezultojë nga kjo diferencë, do të jetë e zbritshme, por nëse kjo humbje, kontribuon në një humbje të përgjithshme për vitin, atëherë ajo mund të anulohet.

55.3 Personin juridik që mban aktivin trajtohet si riblerës i aktivitet që është trajtuar si i transferuar. Në këtë mënyrë, ndërkohë që personi juridik trajtohet sikur ta transferojë aktivin, ky person mbetet përsëri zotëruesi (pronari) i aktivitet. Kostoja e aktivitet do të ndryshojë për shkak të transferimit dhe riblerjes së supozuar. Kostoja e re e amortizueshme e aktivitet do të jetë e barabartë me të ardhurat e shitjes që personi juridik konsiderohet se do të marrë.

Shembull 1

Supozohet që kostoja e aktivitet është 80 milionë lekë dhe vlera e tregut është 100 milionë lekë. Në një transferim që sjell një ndryshim 100% të pronësisë, personi juridik fiton 20 milionë lekë (të ardhurat nga shitja 100 milionë–80 milionë kosto e aktivitet), shumë e cila përfshihet në të ardhurat e tatueshme të personit juridik. Kostoja e asetit më pas rivlerësohet në 100 milionë lekë. Nëse aktivi është subjekt i amortizimit, amortizimi do të llogaritet mbi koston prej 100 milionë lekë (jo 80). Në mënyrë të ngjashme, nëse aktivi shitet më pas, vlera 100 milionë do të përdoret si kosto historike e aktivitet për të përcaktuar nëse ka një fitim ose humbje në shitje.

Shembull 2

Supozojmë se ndryshimi i pronësisë së personit juridik është 60%, pra pala e tretë blen vetëm 60% të aksioneve të tij. Në këtë rast vetëm 60% e një aktivitet trajtohet si i shitur dhe vetëm 60% e vlerës së tregut të aktivitet trajtohet si e ardhur nga shitja. Për këtë arsye vetëm 60% e koston së aktivitet do i atribuohet transferimit. Fitimi do të jetë 12 milion lekë: $(100 \text{ milion} \times 60\% = 60 \text{ milion}) - (80 \text{ milion} \times 60\% = 48)$. Pra $60-48=12$ milion lekë fitim, shumë e cila do përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit juridik. Kostoja e re e aktivitet do të jetë pjesa e koston së vjetër që i atribuohet pjesës së aktivitet që nuk disponohet $(80-48=32)$ plus të ardhurat e shitjes të trajtuara si të marra (60). Pra, nëse aktivi është një aktivitet i amortizueshëm baza nga e cila do të amortizohet pas ndryshimit të pronësisë do të jetë 92 milion lekë $(32+60)$.

55.4 Neni 54 zbatohet në të gjitha rastet nëse personi juridik është rezident ose jorezident në Shqipëri dhe nëse pasuritë i atribuohen aseteve të një selie të përhershme në Shqipëri, por me kusht që për tre vitet paraardhëse mesatarja e qarkullimit të realizuar të jetë mbi 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë. Tatimi mbi çdo fitimin që rezulton nga transferimi I aseteve aplikohet për të gjitha pasuritë pavarësisht nga vlera e tyre, pavarësisht nëse ato janë të luajtshme ose të paluajtshme.

55.5 Me qëllim shmangien e tatimit të dyfishtë, kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin për shkak të një transferimi të parashikuar sipas pikës 1, atëherë shitja e aksioneve që shkaktoi ndryshimin e pronësisë (transferimin e supozuar) është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

Shembull 3

Një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie të vendosur në ishujt Kayman, e cila është tërësisht në pronësi të një personi rezident të një vendi tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të paluajtshme me një vlerë tregu më të lartë se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme, jo drejtpërsëdrejti, por duke blerë aksione në shoqërinë e regjistruar në ishujt Kayman. (supozohet se më shumë se 50% të vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve Kayman i atribuohet pasurisë së paluajtshme, në Shqipëri). Pra, shoqëria shqiptare do të pësojë një ndryshim të pronësisë dhe kështu do të trajtohet si të transferojë pronën e paluajtshme për vlerën e tregut dhe më pas rimarrëse e saj. Transaksioni do rezultojë

në një fitim që është i tatueshëm për shoqërinë shqiptare. Neni 54 përjashton nga tatimi mbi fitimin shitjen e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kayman, me kusht që shitja të tatóhet në shoqërinë rezidente shqiptare.

55.6 Një person juridik që pëson një ndryshim të pronësisë duhet të njoftojë autoritetin tatimor brenda 45 ditëve nga ndryshimi. Njoftimi duhet të përmbajë detajet e ndryshimit, si palët e përfshira në transaksionet që shkaktojnë ndryshimin, ashtu edhe marrëdhëniet e tyre me personin juridik në fjalë. Gjithashtu njoftimi përfshin edhe kushtet e transaksionit, përfshirë të ardhurat e shitjeve dhe mënyrën se si këto të ardhura janë llogaritur.

55.7 Pika 4 e nenit 27/1 shtrin kërkesën e njoftimit të paragrafit 3) përtej ndryshimeve të pronësisë për të cilat zbatohet rregulli i transferimit të supozuar sipas pikës 1) (ndryshim pronësie me më shumë se 20 %). Kjo është efektivisht një kërkesë njoftimi për shitjet indirekte, ato ku realizohet fitimi nga shitja e aksioneve i cili kërkohet të tatóhet. Si e tillë, kërkesa për njoftim aplikohet vetëm për transferimet indirekte të pasurisë së paluajtshme.

Shembull 4

Supozohet se një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie e vendosur në ishujt Kayman, që është tërësisht në pronësi të një personi rezident në një vend tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të paluajtshme me një vlerë tregu më të lartë se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme të vendosur në Shqipëri, jo drejtpërdrejt, por duke blerë 15% të aksioneve në shoqërinë e ishujve Kayman. Supozojmë që më shumë se 50% e vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve të Kajmanit i atribuohet pasurisë së paluajtshme të vendosur në Shqipëri.

55.8 Ndryshimi i pronësisë së shoqërisë shqiptare është më pak se 20%, pra rregulli i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 55 nuk zbatohet. Megjithatë, fitimi i realizuar nga transferimi i aksioneve ka burimin në Shqipëri, prandaj kërkohet që shoqëria shqiptare të njoftojë autoritetin tatimor për shitjen e 15% të aksioneve në shoqërinë mëmë të ishujve Kayman.

55.9 Detyrimi për njoftim nuk zbatohet nëse shitja e aksioneve rezulton në më pak se 10% ndryshim në pronësinë e shoqërisë shqiptare. Kufiri prej 10% presupozon që shoqëria shqiptare mund të mos jetë në dijeni të transaksionit të shitjes. Megjithatë, edhe pse nuk pa pasur detyrim për njoftim, nëse ndryshimi është nën 10%, shitja e aksioneve mbetet e tatueshme në Shqipëri, me kusht që aksionet të marrin më shumë se 50% të vlerës së tyre nga pasuria e paluajtshme në Shqipëri.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME TË MBAJTJES SË TATIMIT NË BURIM

56. Agjenti i mbajtjes së Tatimit në Burim

1. Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim detyrohet:

- a. Të mbajë tatimin kur bën ndonjë nga pagesat e listuara në nenin 58 “Të ardhurat dhe pagesat, objekt i mbajtjes së tatimit në burim”, të këtij ligji;
- b. Të transferojë shumën e saktë të tatimit, në afatin e kërkuar të tatimit të mbajtur, në llogarinë e autoritetit kompetent tatimor;

- c. Të dorezojë deklaratën e detajuar “Deklarata e tatimit të mbajtur në burim” ku identifikohet cdo përfitues i të ardhurave, qoftë individ, person fizik tregtar, i vetpunësuar apo entitet, qofshin këto rezidentë apo jo rezidentë, duke treguar edhe tatimin përkatës që i është mbajtur në burim;
- d. Të mbajë regjistrime të pagesave të bëra, tatimit të llogaritur për tu transferuar në buxhet, dhe t’ia vendosë në dispozicion cdo dokument autoritetit tatimor kur i kërkohet, me qëllim verifikimin e saktësisë së llogaritjes, mbajtjes dhe /ose pagesës së tatimit.

2. Data e pagesës së të ardhurave që janë subjekt të mbajtjes së tatimit në burim, nënkupton ose datën në të cilën është bërë pagesa, ose datën në të cilën agjenti i mbajtjes së tatimit në burim ka llogaritur detyrimin në fjalë, cilado nga këto ngjarje ndodh më herët.

3. Për pagesën e dividendit të deklaruar, tatimi i të cilit duhet të mbahet në burim, dhe që nuk është paguar, tatimi duhet të mbahet dhe të transferohet maksimalisht në fund të muajit të tretë pas muajit në të cilin organi stautor i entitetit ka vendosur mbi shpërndarjen e fitimit përkatës. Nëse organi kompetent i entiteti ka vendosur të shpërndajë dividend në mbledhjen e datës 31 maj 2024, tatimi mbi dividendin duhet të transferohet në llogarinë e të ardhurave të buxhetit jo më vonë se 31 gusht 2024.

4. Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim është përgjegjës për pagesën e tatimit në emër të një tatimpaguesi tjetër njëlloj si të ishte detyrimi i tyre tatimor. Agjenti i mbajtjes së tatimit detyrohet të deklarojë dhe paguajë tatimin e mbajtur në llogarinë e të ardhurave të organeve tatimore, deri në datën 20-të të muajit që pason muajin e pagesës ose mbajtjes së tatimit.

5. Edhe punëdhënësit (agjenti i listëpagesës) konsiderohet agjent i mbajtjes së tatimit në burim në lidhje me detyrimet që ka për mbajtjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

57. Deklarata e Tatimit të Mbajtur në Burim

1. Deklarata e tatimit në burim është sipas Modelit nr... Bashkengjitur

2. Deklarata përmban cdo të dhënë identifikuese për paguesin dhe përfituesin e të ardhurës, qoftë ky entitet, përfshirë edhe entitetet jo fitimprurëse apo që nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ, person fizik tregtar, i vetpunësuar apo individ.

58. Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim.

58.1 Kategoritë e të ardhurave sipas gërmave “a” deri “e” të paragrafit 1 në nenin 58, të ardhura për të cilat ligji përcakton se tatimi për përfituesin e të ardhurës mbahet në burim nga paguesi i të ardhurës në momentin e pagesës, përfshijnë rastet kur pagesa bëhet në favor të një tatimpaguesi rezident shqiptar, ose të një tatimpaguesi jo-rezident, por i cili ka krijuar një seli të përhershme në Shqipëri.

58.2 Për kategoritë e të ardhurave sipas gërmave “a” deri “e” të paragrafit 1 në nenin 58, mbajtja e tatimit në burim bëhet pavarësisht nëse përfituesi i të ardhurës, (rezident shqiptar, apo jorezident por që ka seli të përhershme në Shqipëri) është individ, person fizik tregtar, i vetpunësuar, apo entitet..

58.3 Tatimi në burim mbahet në të gjitha rastet kur bëhen pagesa që hyjnë në konceptin e honorareve (të drejta autori, pagesa license, marke, të drejte përdorimi, etj të kësaj natyre). Tatimi mbi pagesat e honorareve mbahet pavarësisht se përfituesi i të ardhurës është entitet, individ, i vetpunësuar apo tregtar. Secila prej kategorive të tatimpaguesve ka të drejtë që ta kreditojë tatimin e mbajtur në burim mbi honorarët, në detyrimin tatimor të pagueshëm për të ardhurat e tij.

58.4. Tatimi në burim mbahet në të gjitha rastet kur bëhen pagesa në lidhje me të ardhurat nga lojërat e fatit. Zakonisht, fituesit e lojrave të fatit janë individë të cilet, tatimin e mbajtur në burim për të ardhurat nga lojrat e fatit, e kanë tatim përfundimtar.

58.5 Tatimi në burim mbahet edhe kur bëhen pagesa në lidhje me qiratë, por vetëm kur qeradhënësi, përfitues i të ardhurës, është individ dhe qeramarrësi është ose entitet, ose i vetpunësuar, ose tregtar, ose ent shtetëror, OJF, Projekt, Program, pra kur qeramarrësi është person i pajisur me Numurin Unik të Identifikimit të Subjektit dhe bën pagesa qeraje në favor të një individi përfitues, bazuar në kontratën e qerasë.

58.5.1 Në mënyrë të përmbledhur, tatimi në lidhje me qeratë mbahet/nuk mbahet në burim nga qeramarrësi në vartësi të statusit të paguesit dhe përfituesit si më poshtë:

a. Në rastet kur qeramarrësi është: (i) entitet subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ; (ii) tregtar subjekt i tatimit mbi të ardhurat; (iii) i vetpunësuar subjekt i tatimit mbi të ardhurat; (iv) entitet, jo subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ dhe:

- i) qeradhënësi është entitet subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ- Nuk mbahet tatim
- ii) qeradhënësi është i vetpunësuar apo tregtar subjekt i tatimit mbi të ardhurat-Nuk mbahet tatim
- iii) qeradhënësi është individ- Mbahet tatim
- iv) qeradhënësi është entitet jo subjekt i tatimit mbi te ardhurat- Nuk mbahet tatim

b. Në rastet kur qeramarrësi është individ dhe:

- i) qeradhënësi është entitet subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ- Nuk mbahet tatim
- ii) qeradhënësi është i vetpunësuar apo tregtar subjekt i tatimit mbi të ardhurat-Nuk mbahet tatim
- iii) qeradhënësi është individ- Nuk mbahet tatim
- iv) qeradhënësi është entitet jo subjekt i tatimit mbi te ardhurat- Nuk mbahet tatim

58.5.2 Për rastet kur personat e pajisur me NUIS: entitetet subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ, të vetpunësuarit dhe tregtarët subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale si dhe entitetet qe nuk janë subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ si entet publike, OJF-të etj, bëjnë pagesa qeraje për individë, ato gjithmonë mbajnë tatimin në burim i cili është tatim përfundimtar i paguar nga individi qeradhënës. Personat e pajisur me NUIS, kanë detyrimin e dotëzimit të deklaratës së tatimit të mbajtur në burim dhe pjesë e kësaj deklarate është edhe tatimi mbi qeratë.

58.5.3 Për rastet kur qeramarrës është një individ, dhe nëse qeradhënësi është subjekt i pajisur me NUIS (entitet, tregtar, i vetpunësuar, por edhe ent shtetëror apo OJF) individi që bën pagesën e qerasë nuk mban ndonjë tatim në burim. Edhe nëse qeradhënësi dhe qeramarrësi janë yindividë, nuk mbahet ndonjë tatim në burim Duke mos patur detyrimin per të mbajtur tatim në burim, pavarësisht nga statusi i qeramarrësit, individi përfitues i qerasë, vetdeklaroi

të ardhurën dhe paguan detyrimin tatimor sipas procedurave të deklarimit dhe pagesës që zbatohen për këto raste.

58.6 Për rastet kur ndonjë entitet merr ndonjë shërbim nga një individ resident, apo jorezident, i cili nuk është i pajisur me NUIS, pra nuk është i vetpunësuar, mbajtja e tatimit në lidhje me pagesën që ai përfiton sqarohet në nenin 65, paragrafi 1, gërma “b” e ligjit.

58.7 Rastet kur nuk mbahet tatimi në burim në lidhje me paragrafin 1 të nenit 58 të ligjit, janë listuar në paragrafin 3 të po këtij neni dhe përfshijnë:

- a. të ardhurat sipas kategorive “a” deri “e” të paragrafit 1 të nenit 58, dhe që mund ti paguhen personave të përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat. Përjashtimi për këtë kategori bëhet pasi personat e përjashtuar nga tatimi mbi fitimin korporativ, edhe nëse realizojnë ndonjë fitim, nuk e destinojnë atë për shpërndarje në përfitim të themeluesve, sikurse është rasti i Organizatave jo Fitimptuese.
- b. **Për dividendët,** të ardhurat nga dividendët që shpërndahen sipas kushteve të përcaktuara në nenin 29 “Përjashtimi në Pjesëmarrje” të këtij ligji. Nëse entiteti “A”, zotëron më pak se 10 % të kapitalit, aksioneve apo të drejtavë të votës në entitetin “B” dhe ky i fundit shpërndan dividend, entiteti “B” duhet të mbajë tatimin mbi dividendin e përfituar nga entiteti “A” sipas normës në fuqi në momentin e shpërndarjes dhe ta transferojë atë në llogaritë e buxhetit të shtetit. Ndërkohë, entiteti “A” i cili ka paguar tatimin mbi dividendin, duhet ta pasqyrojë dividendin e marrë si të ardhur dhe të zbrese nga detyrimi i tatimit mbi fitimin korporativ shumë e tatimit mbi dividendin të mbajtur në burim.
- c. **Për interesat:**
 - i) të ardhurat nga interesat nga emetimi i Eurobondit prej Qeverisë Shqiptare, të paguara entiteteve jorezidente, pa një seli të përhershme në Shqipëri si dhe fitimet kapitale që mund të realizohen nga tregtimi i tyre po nga kjo kategori personash
 - ii) të ardhurat nga interesat që u paguhen bankave dhe institucioneve të tjera financiare.

58.8 Kategoritë e të ardhurave sipas gërmeve “a” deri “g” të paragrafit 2 në nenin 58, të ardhura për të cilat ligji përcakton se tatimi për përfituesin e të ardhurës mbahet në burim nga paguesi i të ardhurës në momentin e pagesës, përfshijnë rastet kur pagesa bëhet në favor të një tatimpaguesi person fizik jo rezident, ose një entitet jo rezident pa një seli të përhershme në Shqipëri:

- a. dividendët, interesat dhe honoraret. Për këto kategori të ardhurash, tatimi mbahet në burim nga paguesi. Në rast se përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, e cila është në fuqi, zbatohen klauzolat e marrëveshjes në lidhje me ndarjen e së drejtës së taksimit. Nëse përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë nuk ka Marrëveshje të tillë në fuqi, në çdo rast zbatohet legjislacioni i brendshëm dhe mbahet tatimi në Shqipëri;
- b. fitimet nga lojrat e fatit, mbahet tatimi në Shqipëri;
- c. shërbimet që i atribuohen një selie të përhershme në Shqipëri sipas nenit 4 të këtij ligji. Në rast se përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e

Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, e cila është në fuqi, zbatohen klauzolat e marrëveshjes në lidhje me afatin e përcaktuar në marrëveshje në lidhje me ndarjen e së drejtës së taksimit. Nëse përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë nuk ka Marrëveshje të tillë në fuqi, në çdo rast zbatohet legjislacioni i brendshëm dhe mbahet tatimi në Shqipëri;

- d. primet e sigurimit, mbahet tatimi në Shqipëri;
- e. të ardhurat nga pjesëmarrjet në bordet drejtuese dhe këshillat ose trupa drejtues të tjerë. Të ardhura të tilla konsiderohen me burim në Shqipëri, lidhen me menaxhimin e veprimtarive që e kanë selinë e përhershme në Shqipëri, rrjedhimisht taten në Shqipëri, pavarësisht faktit se ndonjë takim i bordit, këshillit etj, zhvillohet në Shqipëri, online apo në ndonjë vend tjetër;
- f. të ardhurat nga shërbimet e ndërtimit, instalimit, montimit ose punë mbikëqyrëse të lidhura me to. Në rast se përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë ka nënshkruar Marrëveshje për eliminimin e tatimit të dyfishtë, e cila është në fuqi, zbatohen klauzolat e marrëveshjes në lidhje me afatin e përcaktuar në marrëveshje në lidhje me ndarjen e së drejtës së taksimit për shërbimet e ndërtimit, instalimit, montimit. Nëse përfituesi i të ardhurës është rezident në një shtet me të cilin Republika e Shqipërisë nuk ka Marrëveshje të tillë në fuqi, në çdo rast zbatohet legjislacioni i brendshëm dhe mbahet tatimi në Shqipëri;
- g. të ardhurat nga performanca e aktorëve, muzikantëve ose sportistëve, përfshirë të ardhurat nga personat që punësojnë artistë ose sportistë ose veprojnë si ndërmjetës në organizimin e shfaqjeve apo performancave, mbahet tatimi në Shqipëri. Të ardhura të tilla zakonisht taksohen në vendin ku zhvillohet shfaqja, eventit, aktiviteti, edhe në rastet kur ka Marrëveshje në fuqi.

59. Norma e mbajtjes së tatimit në burim

59.1 Për pagesat në lidhje me dividendët dhe shpërndarjet e fitimit të miratuar nga organet drejtuese të entitetit, paguesi i të ardhurës mban tatimi në burim sipas normës ligjore 8 %.

59.2 Për çdo kategori tjetër të ardhurash të listuara në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 58, përjashtuar ato të përmendura në pikën 59.1 më lart, norma e zbatueshme e tatimit në burim është 15 %.

59.3 Në rastet kur kemi tërheqje nga kapitali, përfshirë rezervat, entiteti mban tatimin në burim për përfituesin sipas normës tatimore 15 %. Tatimmbajtja nuk zbatohet në rastet kur tërhiqet kuota fillestare e kapitalit të investuar nga personi, kuotë e cila ka qënë e taksuar më parë si e ardhur personale.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME MBI TATIMIN E TRASHËGIMISË, DHURATAVE DHE FITIMEVE NGA LOJRAT E FATIT

60. Tatimi i trashëgimisë, dhuratave dhe fitimeve nga lojrat e fatit

Të ardhurat nga dhuratat, trashëgimitë dhe lojrat e fatit, taten me normën 15 % pa zbritur ndonjë kosto të tyre. Nuk taten të ardhurat nga dhuratat dhe trashëgimitë e parashikuara në paragrafin 7 të nenit 60 të Ligjit.

Për efekt të llogaritjes së të ardhurave nga dhuratat dhe trashëgimia, sendet e dhuruara apo të trashëguara vlerësohen me vlerë nominale ose vlerën e tregut, cila prej tyre është vlera më e madhe. Nëse disponohet një vlerë nominale për sendin e dhuruar apo të trashëguar, ajo krahasohet me vlerën e tregut të këtij sendi dhe cilado prej tyre është më e lartë, përbën bazën apo të ardhurën mbi të cilën aplikohet norma e tatimit 15 %. Rregullat e vlerësimit për vlerën e sendeve të dhuruara apo të trashëguara, bazohen në praktikën e njohura nëpërmjet vlerësuesve të njohur apo akteve zyrtare në fuqi në lidhje me metodologjinë e përcaktimit të vlerës së sendeve.

Shembuj:

- Vlera e një pikturë, automjeti retro, unazë me gur të cmuar, set antik pajisjesh etj etj të kësaj natyre, të dhuruara/trashëguara, mund të përcaktohet nga ekspertë të licensuar të fushës;
- Vlera e një banese të dhuruar/trashëguar, mund të përcaktohen ose me ekspertë të licensuar të fushës, ose duke përdorur aktet ligjore/nënligjore në fuqi për vlerësimin e pasurive të paluajtshme.

DISPOZITA TË MBLEDHJES SË TATIMIT

61. Deklarata Tatimore Vjetore

1. Deklarata tatimore vjetore e fitimit të tatueshëm dorëzohet në administratën tatimore nga:

- a. entitetet të cilat deklarojnë dhe paguajnë tatim mbi fitimin korporativ
- b. personat fizikë tregtarë dhe të vetpunësuarit në lidhje me veprimtarinë ekonomike që ushtrojnë.

2. Deklarata tatimore vjetore e të ardhurave personale/biznesore, dorëzohet në administratën tatimore nga cdo person, me përjashtim të:

- a. individëve sipas përcaktimeve në nenin 67 paragrafi 1 i ligjit, ku përfshihen individët me të ardhura nga punësimi (pagë bruto vjetore) më pak se 1.200.000 lekë në vit vetëm nga një punëdhënës, si dhe individët të cilët kanë realizuar të ardhura, për të cilat tatimi nuk mbahet në burim, dhe që janë më pak se 50.000 lekë në vit.
- b. personave jorezidentë të cilët marrin pagesa që i nënshtrohen tatimit përfundimtar në burim sipas paragrafit 2 të Nenit 58 “Të ardhurat dhe pagesat objekt i tatimit të mbajtur në burim”.

Deklaratat tatimore vjetore, përfshirë Deklaratën tatimore vjetore të fitimit të tatueshëm dhe Deklaratën tatimore vjetore e të ardhurave personale/biznesore, dorëzohen në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor, për të cilin dorëzohet deklarata.

3. Trashëgimtarët ligjorë të personit janë përgjegjës për plotësimin e deklaratës, në rast se tatimpaguesi ka vdekur. Kjo deklaratë duhet të përfshijë të ardhurat e përgjithshme të krijuara deri në datën e vdekjes.

4. Në rast se tatimpaguesi ndryshon rezidencën tatimore, ai duhet të bëjë deklaratë tatimore për çdo të ardhur të krijuar deri në datën e ndryshimit të rezidencës. Shembull: Nëse një individ rezident shqiptar, i cili ka detyrimin për të deklaruar të ardhurat, largohet nga Shqipëria në 31 korrik 2024, ai ka detyrimin e deklarimit të të ardhurave për periudhën e rezidencës në Shqipëri janar-korrik 2024.

5. Deklarimi nga tatimpaguesit realizohet sipas përcaktimeve në Ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nenligjore për zbatimin e tij. Dorëzimi i deklaratës bëhet në rrugë elektronike, sipas formulareve përkatës të deklarimit, bashkëngjitur këtij Udhëzimi:

- Deklarata vjetore e tatimit mbi fitimin korporativ e cila dorëzohet nga subjektet që paguajnë tatim mbi fitimin korporativ.
- Deklarata vjetore e tatimit mbi fitimin nga personat fizikë tregtarë dhe të vetpunësuar, e cila dorëzohet nga personat fizikë tregtarë dhe personat fizikë të vetpunësuar.
- Deklarata e tatimit mbi të ardhurat personale e cila dorëzohet nga individët sipas dispozitave të Ligjit.

Tatimpaguesit të cilët janë të detyruar të mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” paraqesin pranë administratës tatimore deklaratën tatimore. Bazuar më Ligjin ‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, Administrata tatimore ka të drejten të kërkojë cdo informacion të parashikuar nga ky ligj, ndërkohë që tatimpaguesit kanë detyrimin që ti japin Administratës Tatimore informacionin e kërkuar. PAGESA detyrimeve tatimore sipas deklaratës, paguhet në llogaritë e autorizuara nga thesari i buxhetit të shtetit.

62. Kërkesat për Dokumentacion

62.1 Tatimpaguesit subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ dhe i tatimit mbi të ardhurat nga biznesi (tregtarët dhe të vetpunësuarit) llogarisin bazën e tatimit (fitimin neto) duke zbritur nga të ardhurat bruto, shpenzimet e zbritshme. Të dhënat pasqyrohen të plota në deklaratën përkatëse duke plotësuar cdo rubrikë të saj.

62.2 Për efekt të njohjes si shpenzim i zbritshëm, tatimpaguesi duhet të disponojë një faturë, sic përcaktohet në ligjin “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”:

- a. Faturë elektornike për shitjet pa para në dorë-, të lëshuar nga subjektet rezidentë të detyruar për lëshimin e faturave;
- b. Autofaturë në kuptim të ligjit “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”;
- c. Faturë importi sipas procedurave doganore;
- d. Faturë të lëshuar nga personi jorezident për shërbime;
- e. Dokument të njohur për pagesa tarifash e te tjera të kësaj natyre të bera për institucione si ente shtetërore, entitete me status diplomatik si ambasada etj.

63. Parapagimet

1. Llogaritja e kësteve të parapagimit gjatë vitit tatimor për tatimin mbi fitimin korporativ

Tatimpaguesi subjekt i tatimit mbi fitimin korporativ, gjatë vitit tatimor, parapaguan këstet mujore/tremujore të tatimit mbi fitimin:

- brenda datës 31 mars, për muajt janar, shkurt, mars;
- brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj, qershor;
- brenda datës 30 shtator, për muajt korrik, gusht, shtator; dhe,
- brenda datës 31 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhjetor.

Bazuar në të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës, të dorëzuar nga tatimpaguesi, deklaratë që duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit vijues, Administrata Tatimore llogarit këstet mujore dhe ato tremujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin korporativ për periudhën prill–dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm. Këstet e parapagimeve i njoftohen tatimpaguesit në rrugë elektornike në llogarinë e tij brenda datës 10 prill të vitit vijues.

Këstet e llogaritura të parapagimeve paguhen nga tatimpaguesi në fund të cdo 3 mujori, por mund të paguhen edhe në bazë mujore, brenda datës 15 të cdo muaji. Kur këstet e parapagimeve paguhen në bazë tremujore, kësti i çdo tremujori llogaritet si shumë e kësteve të çdo muaji të tremujorit përkatës.

2. Llogaritja e kësteve të parapagimeve të tatimit mbi fitimin korporativ:

2.1 Në rastet kur tatimpaguesi ka më shumë se një periudhë tatimore të mëparshme që e ka filluar veprimtarinë ekonomike, këstet mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin llogariten si më poshtë:

Shembull për llogaritjen e parapagimeve për vitin aktual 2023 e në vijim:

Tatimi mbi fitimin i vitit 2022 ka qënë 1,200,000 lekë. Këstet mujore/tremujore të parapagimeve për vitin 2023 do të jenë:

- Pra për 3 mujorin e parë të vitit 2023, kësti i parapagimeve është përcaktuar në prill të vitit paraardhës 2022, bazuar në deklaratën e fitimit të tatueshëm të vitit 2021.
- Për periudhën prill - dhjetor 2023: $1,200,000/12$ muaj = 100,000 lekë/muaj. Totali për 9- Mujorin prill-dhjetor 2023 do jetë $100,000 \times 9$ muaj = 900,000 lekë, ose 300,000 lekë për cdo 3 mujor ose 100,000 lekë cdo muaj.
- Për periudhën janar - mars 2024: $1,200,000/12$ muaj = 100,000 lekë/muaj. Totali për 3-mujorin e parë të vitit pasardhës 2024 është $100,000 \times 3$ muaj = 300,000 lekë, ose 100,000 lekë cdo muaj.

2.2 Në rastet kur tatimpaguesi ka më pak se një periudhë tatimore që e ka filluar veprimtarinë ekonomike, këstet mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin llogariten si më poshtë:

Shembull:

Të dhënat: Veprimtaria ekonomike ka filluar në datën 1 prill 2022. Tatimpaguesi ka deklaruar se tatimi mbi fitimin i vlerësuar prej tij për periudhën prill-dhjetor 2022 dhe janar-mars 2023 mund të jetë 100.000 leke çdo muaj.

Sipas bilancit të depozituar për veprimtarinë ekonomike të vitit 2022, tatimi mbi fitimin për periudhën prill-dhjetor rezulton 1.350.000 lekë.

Llogaritja e parapagimeve të tatimit mbi fitimin për periudhat në vijim:

- Për periudhën janar-mars 2023 është marrë në konsideratë vetvlerësimi i tatimpaguesit në prill 2022 dhe parapagimet e kësaj periudhe do jenë 100,000 lekë cdo muaj ose 300.000 lekë për 3 mujorin e parë 2023.
- Për periudhën prill-dhjetor 2023: Fitimi i deklaruar për vitin 2022 ka qënë 1.350.000 : 9 = 150.000 lekë në muaj. Pra për periudhën prill-dhjetor 2023 parapagimet e tatimit mbi fitimin do jenë 150.000 lekë cdo muaj ose $150.000 \times 3 = 450.000$ lekë cdo tre mujor, ose 1,350.000 lekë si 9 mujor.
- Për periudhën janar-mars 2024 parapagimet do jenë 150,000 lekë cdo muaj ose $150,000 \times 3 = 450,000$ leke si 3 mujor.

2.3 Në rastet kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë në vitin vijues, këstet mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin llogariten duke u bazuar në deklaratën parashikuese të tatimpaguesit për shumën e vlerësuar të fitimit dhe tatimit mbi fitimin, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur deri në fund të vitit, por pa marrë në konsideratë muajin e parë të regjistrimit. Kjo formulë llogaritjeje do të shërbejë edhe për përcaktimin e kësteve mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin për 3-mujorin e parë të vitit pasardhës. Për 9-mujorin në vijim prill-dhjetor të vitit pasardhës, këstet mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin llogariten duke marrë në konsideratë të dhënat e deklaratës së fitimit të tatueshëm të vitit paraardhës.

Shembull:

Tatimpaguesi regjistrohet në datën 10 gusht 2023 dhe deklaron se tatimi mbi fitimin e tij për periudhën e mbetur të vitit 2023 do të jetë 800.000 lekë.

Këstet e tij mujore të parapagimevetë tatimit mbi fitimin llogariten:

- Për secilin nga muajt e periudhës shtator-dhjetor 2014 : $800.000 : 4 = 200.000$ lekë/muaj
- Për secilin nga muajt e tremujorit të parë 2024: 200.000 lekë/muaj, ose $200,000 \times 3 = 600$ mijë lekë si 3 mujor i parë 2024.

E njëjta metodologji do përdoret për llogaritjen e kësteve mujore/tremujore të parapagimeve të tatimit mbi edhe në rastet kur periudhat paraardhëse tatimore kane rezultuar me humbje.

3. Korigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënieve të tatimit mbi fitimin korporativ.

Tatimpaguesi, në çdo muaj gjatë periudhës tatimore, mund të kërkojë dhe të provojë para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse. Në këto raste organi tatimor, bazuar në argumentet, dokumentacionin dhe të evidencat e tatimpaguesit, zvogëlojnë shumën e llogaritura të parapagimeve.

Argumentet që mund të parashtrijë tatimpaguesi për të kërkuar reduktimin/heqjen e kësteve të llogaritura të parapagimit janë:

- Kur shitjet e deklaruara në 3 mujorin e fundit, janë ulur me mbi 20 % krahasuar me shitjet mesatare mujore të 12 mujorit të fundit para këtij 3 mujori. Reduktimi i kësteve bëhet në proporcion me reduktimin e shitjeve të mallrave dhe shërbimeve.
- Kur blerjet e deklaruara në 3 mujorin e fundit, janë ulur me mbi 30 % krahasuar me blerjet mesatare mujore të 12 mujorit të fundit para këtij 3 mujori. Reduktimi i kësteve për parapagimet bëhet në proporcion me reduktimin e blerjeve të mallrave dhe shërbimeve.
- Kur ka mungesa në vijim të kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin.
- Kur përfundojnë kontrata mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, kanë përfunduar objektet apo punët e tjera publike të kontraktuara.
- Kur kanë ndodhur fatkeqësi apo dëme në veprimtarinë e tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në reduktimin e ndjeshëm të veprimtarisë ekonomike.
- Kur mbyllen linja, veprimtari të caktuara, shkurtohet ndjeshëm forca e punës etj, si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

Në rastet kur kanë ndryshuar kushtet mbi bazën e të cilave këstet e parapagesave janë reduktuar, administrata tatimore, me pëlqimin e tatimpaguesit, i rishikon ato në rritje

4. Korrigjimi në rritje i kësteve mujore të parapagimeve të tatimit mbi fitimin korporativ.

Në rastet kur, bazuar në të dhënat e deklaruara për 9 mujorin e vitit në vijim, rezulton se tatimpaguesi i ka rritur të ardhurat mesatare mujore nga shitja e mallrave dhe shërbimeve me më shumë se 10 % krahasuar me të ardhurat mesatare mujore të vitit të kaluar, administrata tatimore mund të rregullojnë në rritje parapagimet e tre mujorit të fundit të vitit. Rritja e kësteve të parapagimit nuk mund të jetë më shumë se 75 % në përputhje me përqindjen e rritjes së të ardhurave të rezultuara nga krahasimi i vitit korrent me vitin e kaluar.

Shembull:

Të ardhurat bruto mesatare mujore 2022 kanë qënë 100.000 lekë

Të ardhurat bruto mesatare mujore janar-shtator 2023 janë 130.000 lekë

Rritja mesatare mujore e të ardhurave është 30 %

Rritja e kësteve të parapagimeve për periudhën tetor-dhjetor do rriten jo më shumë se 22,5 % (30 % x 75 %) e kësteve të parapagimit të llogaritura në fillim të vitit.

Tatimpaguesi:

- mund ta pranojë vlerësimin e administratës tatimore;
- mund ta rishikojë në rritje, tej vlerësimit të administratës tatimore dhe të kërkojë rritje me të lartë të parapagesave, ose;

- mund të kundërshtojë rritjen e parapagesave të bërë nga administrata tatimore, sipas procedurave të papashikuara të apelimit tatimor.

Në rastet kur tatimpaguesi gjykon vetë se tatimi mbi fitimin i vlerësuar prej tij për vitin vijues, do të jetë mbi 10% më i lartë se këstet mujore të parapagesave të llogaritura sipas ligjit, ai duhet të paraqesë një deklaratë vlerësimi të tatimit mbi fitimin për vitin ushtrimor jo më vonë se data 10 shtator. Mbi këtë bazë administrata tatimore korrigjon në rritje këstet për muajt tetor-dhjetor të vitit vijues.

Shembull:

- Këstet e llogaritura për muajt janar – mars : 300,000 lekë (100,000 lekë/muaj),
- Këstet e llogaritura për muajt prill – shtator : 1,200,000 lekë (200,000 lekë/muaj),
- Këstet janar-shtator: 300,000 + 1,200,000 = 1,500,000 lekë
- Këstet e llogaritura paraprakisht për muajt: tetor- nëntor–dhjetor: 600,000 lekë (3x200,000),
- Këstet për të gjithë vitin ushtrimor: 2,100,000 lekë (300.000 + 1.200.000 + 600.000)

Tatimi mbi fitimin i vlerësuar nga vetë tatimpaguesi që vetdeklarohet deri në 10 shtator është 2,700,000 lekë, pra është mbi 10 për qind më i lartë se këstet mujore të parapagimeve të llogaritura $[(2,700,000-2,100,000)/2,100,000 = 28\%]$. Në këto kushte, kësti shtesë për muajt tetor-dhjetor prej 200.000 lekë në çdo muaj $(2,700,000 - 2,100,000 = 600,000/3 = 200,000$ lekë/muaj).

Nëse si rezultat i auditimit nëpërmjet kontrollit të thelluar dhe vlerësimit tatimor, konstatohet se fitimi i tatimpaguesit në vitin paraardhës është deklaruar më i ulët se ai që rezulton nga auditimi, administrata tatimore mund të rrisë këstet e parapagimeve të llogaritura më parë për vitin vijues dhe 3 mujorin e parë të vitit pasardhës. Rritja e kësteve të parapagimit bëhet në raport me shumën e rritur të fitimit si rezultat i rivlerësimit krahasuar me fitimin e deklaruar.

Administrata tatimore njofton tatimpaguesin për rritjen e kësteve të parapagimeve në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”.

5. Llogaritja e kësteve të parapagimit gjatë vitit tatimor për tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe nga vetpunësimi.

Tatimpaguesi subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetpunësimi, gjatë vitit tatimor, parapaguan këstet tremujore, të tatimit mbi të ardhurat personale:

- brenda datës 31 mars, për muajt janar, shkurt mars;
- brenda datës 30 qershor, për muajt prill, maj qershor;
- brenda dates 30 shtator, për muajt korrik, gusht shtator; dhe,
- brenda datës 31 dhjetor, për muajt tetor, nëntor dhjetor.

Bazuar në të dhënat e deklaratës së tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi, të vitit paraardhës, të dorëzuar nga tatimpaguesi, deklaratë që duhet të dorëzohet brenda datës 31 mars të vitit vijues, Administrata Tatimore llogarit këstet tremujore të parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi për periudhën prill–dhjetor të vitit vijues dhe për periudhën janar – mars të vitit të ardhshëm. Këstet e parapagimeve i njoftohen tatimpaguesit në rrugë elektornike në llogarinë e tij brenda datës 20 prill të vitit vijues.

5.1. Llogaritja e kësteve të parapagimeve:

5.1.1 Në rastet kur tatimpaguesi i tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi, ka më shumë se dy periudha tatimore që e ka filluar veprimtarinë ekonomike, këstet tremujore të parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi, llogariten si më poshtë:

Shembull për llogaritjen e parapagimeve për vitin aktual 2023 e në vijim:

Tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi i vitit 2022 ka qënë 120,000 lekë. Këstet tremujore të parapagimeve do të jenë:

- Për periudhën prill - dhjetor 2023: $120,000/12$ muaj = 10,000 lekë/muaj. Totali për 9-Mujorin prill-dhjetor 2023 do jetë $10,000 \times 9$ muaj = 90,000 lekë , ose 30,000 lekë për cdo 3 mujor.
- Për periudhën janar - mars 2024: $120,000/12$ muaj = 10,000 lekë/muaj. Totali për 3-mujorin e parë të vitit pasardhës $10,000 \times 3$ muaj = 30,000 lekë. Pra për 3 mujorin e parë të vitit pasardhës, kësti i parapagimeve është përcaktuar në prill të vitit paraardhës, bazuar në deklaratën e të ardhurave personale nga biznesi dhe vetpunësimi të vitit 2022.

5.1.2. Në rastet kur tatimpaguesi ka më pak se një periudhë tatimore që e ka filluar veprimtarinë ekonomike, këstet tremujore të parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi llogariten si më poshtë:

Shembull:

Të dhënat:

Veprimtaria ekonomike ka filluar në datën 1 prill 2022. Tatimpaguesi ka deklaruar se tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi i vlerësuar prej tij për periudhën prill-dhjetor 2022 mund të jetë 10.000 leke cdo muaj.

Sipas bilancit të depozituar për veprimtarinë ekonomike të vitit 2022, tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi për periudhën prill-dhjetor ka rezultuar 135,000 lekë.

Llogaritja e parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi për periudhat në vijim:

- Për periudhën janar-mars 2023 do merret në konsideratë vetvlerësimi i tatimpaguesit në prill 2022 dhe parapagimi i kësaj periudhe do jetë 30,000 lekë për 3 mujorin e parë 2023.
- Për periudhën prill-dhjetor 2023: Tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi i deklaruar për vitin 2022 ka qënë $135,000 : 9 = 15,000$ lekë në muaj. Pra për periudhën prill-dhjetor 2023 parapagimet e tatimit mbi fitimin do jenë $15,000 \times 3 = 45,000$ lekë cdo 3 mujor.
- Për periudhën janar-mars 2024 parapagimet do jenë $15,000 \times 3 = 45,000$ si 3 mujor

5.1.3. Në rastet kur tatimpaguesi e fillon veprimtarinë në vitin vijues, këstet tremujore të parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi llogariten duke u bazuar në deklaratën parashikuese të tatimpaguesit për shumën e vlerësuar të të ardhurës

personale nga biznesi/vetpunësimi, dhe tatimit mbi këtë të ardhur, pjesëtuar me numrin e muajve të mbetur deri në fund të vitit, por pa marrë në konsideratë muajin e parë të regjistrimit. Kjo formulë llogaritur do të shërbejë edhe për përcaktimin e kështit të parapagimit të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi për 3-mujorin e parë të vitit pasardhës. Për 9-mujorin në vijim prill-dhjetor të vitit pasardhës, kështet tremujore të parapagimeve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi llogariten duke marrë në konsideratë të dhënat e deklaratës së të ardhurave personale të tatueshme të vitit paraardhës.

Shembull:

Tatimpaguesi regjistrohet në datën 10 shtator 2023 dhe deklaron se tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi/vetpunësimi i tij për periudhën e mbetur të vitit 2023 do të jetë 60.000 lekë.

Kështet e tij tremujore të parapagimeve të tatimit llogariten:

- Për tremujorin e fundit tetor-dhjetor 2023: 60,000 lekë
- Për tre mujorin e parë 2024: 60.000 lekë

E njëjta metodologji do përdoret për llogaritjen e kësteve mujore/tremujore të parapagimeve të tatimit mbi edhe në rastet kur periudhat paraardhëse tatimore kane rezultuar me humbje.

6. Korrigjimi i kësteve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetpunësimi.

Korrigjimi në ulje i kësteve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetpunësimi mund të kërkohet në cdo kohë nga tatimpaguesi, ndërsa korrigjimi në rritje i tyre mund të bëhet vetëm për 3 mujorin e fundit të vitit.

Për korrigjimin e kësteve të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe vetpunësimi, zbatohen parimet e parashikuara në pikat 3 dhe 4 më lart, të parashikuara për tatimin mbi fitimin korporativ.

64. Deklarata plotësuese tatimore

64.1 Tatimpaguesi ka detyrimin që nëse konstaton se tatimi i pagueshëm në deklaratën e tij të fundit të të ardhurave duhet të ishte më i lartë ose humbja tatimore më e ulët, të dorëzojë një deklaratë tatimore shtesë dhe të paguajë diferencën midis tatimit të deklaruar më parë të pagueshëm dhe tatimit suplementar të pagueshëm, brenda 30 ditëve nga konstatimi i diferencës. Në këtë rast ndaj tij nuk vendosen penalitete për plotësimin me vonesë të deklaratës, me përjashtim të kamatvonesave eventuale për pagesë të vonuar.

64.2 E njëjta procedurë ndodh edhe nëse detyrimi tatim i rillogaritur rezulton më i ulët. Në këtë rast shumat e mbipaguara mund të kërkohen vetëm në deklaratën tatimore shtesë dhe që përmban shumën e tatimi më të lartë për t'u kthyer.

65. Agjenti Tatimor i Listëpagesës

Punëdhënësi konsiderohet “agjent tatimor” në lidhje me detyrimin tatimor të të punësuarve, detyrim i cili lidhet me të ardhurat nga punësimi i tyre. Punëdhënësi në rolin e “agjentit tatimor” ka detyrimet e parashikuara në Ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Ligjin “Për Procedurat Tatimore” dhe është përgjegjës për llogaritjen e detyrimit tatimor, mbajtjen e detyrimit nga

pagesa dhe transferimin e këtij detyrimi në llogaritë e të ardhurave të buxhetit të shtetit. Brenda datës 20 të muajit pasardhës, krahas pagesës së detyrimit, punëdhënësi njëkohësisht dorëzon cdo muaj listëpagesën ku janë të pasqyruara të gjithë elementët e pagës bruto, zbritjet e bazës tatimore për llogaritjen e kontributeve, bazës tatimore për llogaritjen e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi si dhe pagën neto të përfituar nga punëmarrësi.

Punëdhënësi, në rolin e agjentit tatimor të listëpagesës, mban tatimin nga paga sipas parashikimeve të nenit 24 “Normat tatimore” të Ligjit. Zbritja nga baza e tatimit (nga paga bruto) e parashikuar në paragrafin 1 të nenit 22 “Zbritjet nga baza tatimore” lejohet të bëhet nga punëdhënësi, nëse punëmarrësi tatimpagues i tatimit mbi pagën, ka nënshkruar deklaratën mbi statusin personal me këtë punëdhënësi, sipas nenit 66 “Deklarata mbi statusin personal” të Ligjit.

Nëse punëmarrësi hyn në marrëdhënie punësimi edhe me punëmarrës të tjerë, ai nuk ka të drejtë të përfitojë “Zbritje nga baza tatimore” tek këta punëdhënësi të tjerë. Punëdhënësit e tjerë do të aplikojnë shkallën progresive të tatimit sipas nenit 24, të ligjit.

Punëmarrësi që është në marrëdhënie punësimi me më tepër se një punëdhënësi, dorëzon deklaratën mbi statusin personal, sipas nenit 66 “Deklarata mbi statusin personal” tek punëdhënësi kryesor ku konsumon kohën më të madhe të punës apo ku ka nivelin më të lartë të pagës.

Punëmarrësit e punësuar në më shumë se një punëdhënësi, bazuar në Nenin 67 “Deklarata vjetore e të ardhurave personale” Paragrafi “1/b”, kanë detyrimin për të të dorëzuar Deklaratën vjetore tatimore personale, ku llogarisin edhe detyrimin tatimor përfundimtar nga punësimi në më shumë se një punëdhënësi, apo edhe të ardhurat e mundshme nga burime të tjera.

Shembull 1

Punëmarrësi “K.P.” është i punësuar në subjektin “Alpha”, dhe ka kontratë punësimi me pagë bruto mujore 100.000 lekë. Njëkohësisht “K.P.” në darkë punon me orar të reduktuar tek subjekti “Beta” me të cilin ka kontratë punësimi me pagë bruto mujore 50.000 lekë.

Punëmarrësi “K.P.” dorëzon tek punëdhënësi “Alpha” “Deklaratën mbi statusin personal” dhe mbi këtë bazë, subjekti i llogarit në listëpagesë detyrimin e tatimit mbi të ardhurat personale nga paga $100.000 - 30.000 = 70.000 \times 13 \% = 9.100$ lekë tatim.

Punëmarrësi “K.P.” nuk duhet të dorëzojë tek punëdhënësi i dytë “Beta” “Deklaratën mbi statusin personal”. Punëdhënësi “Beta” i llogarit në listëpagesë detyrimin e tatimit mbi të ardhurat personale nga paga $50.000 \times 13 \% = 6.500$ lekë tatim.

Në fund të vitit, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, individi “K.P.”, bazuar në nenin 67 të Ligjit,

është i detyruar të dorëzojë “Deklaratën vjetore e të ardhurave personale” ku do rillogarisë detyrimin tatimor të tatimit mbi të ardhurat përsonele nga paga, pasi ka qënë i dypunësuar”

- Të ardhurat mujore nga paga të realizuara: $100.000 + 50.000 = 150.000$ lekë

- Tatimi i pagueshtëm për të ardhurat e realizuara $150.000 - 30.000 = 120.000 \times 13 \% = 15.600$ lekë
- Tatimi mbi baza mujore i paguar gjatë vitit: $9.100 + 6.500 = 15600$ leke ne muaj
- Tatimi i mbipaguar apo për tu paguar: Zero

Shembull 3

Nëse të ardhurat mujore të individit “K.P.” do ishin 200.000 lekë tek punëdhënësi i parë dhe 180.000 lekë tek punëdhënësi i dytë

- Të ardhurat mujore nga paga të realizuara: $200.000 + 180.000 = 380.000$ lekë
- Tatimi i pagueshtëm për të ardhurat e realizuara $380.000 - 30.000 = 350.000$ lekë në muaj. $(170.000 \times 13 \%) + (180.000 \times 23 \%) = 22.100 + 41.400 = 63.500$ lekë tatim mujor
- Tatimi mbi baza mujore i paguar gjatë vitit: (i) $200.000 \text{ lekë} - 30.000 = 170.000 \times 13 \% = 22100$ lekë tatim dhe (ii) $170.000 \times 13 \% + 10.000 \times 23\% = 24.400$ lekë tatim. Gjithsej tatimi i paguar 46.500 lekë tatim.
- Tatimi mujor shtesë për tu paguar: $63.500 - 46.500 = 17.000$ lekë në muaj ose 204.000 lekë në vit të cilat i punësuari duhet ti paguajë brenda datës 31 mars të vitit pasardhës sipas “Deklaratës vjetore të të ardhurave personale”.

Për tu trajtuar si të ardhura nga punësimi dhe në mënyrë që detyrimi tatimor të llogaritet sipas tarifave progresive 13 % dhe 23 % të parashikuara në ligj, duhet që punëdhënësi të jetë përgjegjës edhe për llogaritjen e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore.

Pagesat e tjera të bëra nga një subjekt.

Nëse një punëmarrës bën pagesa për një individ, i cili në kuptim të Kodit të Punës, nuk është në marrëdhënie punësimi me të, por ofron ndonjë shërbim teknik jo të vazhdueshëm, apo pagesa bëhet për pjesëmarrje në organe drejtuese, këshilluese etj të subjektit, zbatohet norma e tatimit 15 % mbi pagesën bruto të bërë. Shembuj:

- a. pagesa për antarë të këshillave mbikqyrrës, apo organeve të tjera drejtuese, të cilët nuk janë njëkohësisht të punësuar të subjektit pagues por kanë funksione apo janë të punësuar në subjekte të tjerë;
- b. pagesa jo të vazhdueshme në kuptimin e marrëdhënieve të punësimit, për ndonjë shërbim teknik rastësor, për ndonjë konsultë, studim, etj, të ofruara nga individë ekspertë të fushës, të cilët mund të jenë në marrëdhënie punësimi me subjekte të tjera;
- c. pagesa për mësimdhënie, kurse, trajnime nga individë jashtë subjektit, të cilët në kuptim të Kodit të Punës nuk hyjnë në marrëdhënie punësimi me subjektin dhe të cilët janë të angazhuar qoftë si të punësuar në subjekte të tjerë, apo mund të jenë individë të tillë (psh pensionistë) që nuk kryejnë veprimtari të tillë të vazhdueshme.

Nëse pagesat, të cilat nuk janë të lidhura me marrëdhënie punësimi, të tilla si ato të përmendura në paragrafët “b” dhe “c” më sipër bëhen për persona fizikë të vetpunësuar, të pajisur me NIPT, nuk mbahet tatim.

Punëdhënësi mban regjistrime në lidhje me të ardhurat nga punësimi të paguara punëmarrësit, si dhe të tatimit të mbajtur. Listëpagesa sipas Modelit Nr. bashkëngjitur e cila është njëkohësisht edhe “Deklaratë e llogaritjes së Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore dhe e Tatimit mbi të Ardhurat Personale nga Punësimi” dorëzohet në formën, mënyrën dhe afatet e parashikuara nga legjislacioni tatimor dhe ai i sigurimeve shoqërore në fuqi.

Agjentët tatimorë të listëpagesës janë përgjegjës për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga punësimi, me të njëjtën përgjegjësi sikur ai të ishte borxhi i tyre tatimor.

66. Deklarata mbi Statusin Personal

1. Cdo punëmarrës nënshkruan një deklaratë në lidhje me statusin personal të tij para fillimit të pagesës së të ardhurave nga paga.
2. Për subjektet e regjistruar dhe që zhvillojnë veprimtari ekonomike, deklaratat do kërkohej me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” Pra listëpagesa e muajit janar 2023, e cili duhet të deklarohet deri në 20 shkurt 2023, duhet të ketë të pasqyruar zbritjet nga baza e tatimit për ato raste kur punëmarrësit e kanë dorëzuar deklaratën e statusit personal.
3. Për subjektet që regjistrohen rishtazi, deklaratat mbi statusin personal do merret në momentin e fillimit të marrëdhënieve të punësimit të individëve.
4. Një punëmarrës nuk mund të nënshkruajë deklaratën për statusin personal me më shumë se një agjent tatimor të listëpagesës për të njëjtën periudhë kalendarike mujore. Nëse punëmarrësi i cili mund të jetë i punësuar në dy subjekte, ka dorëzuar deklaratën tek punëdhënësi “A” por jo tek punëdhënësi “B”, por në fund të muajit i shkëput marrëdhëniet e punësimit me punëdhënësin “A”, dhe do jetë i punësuar vetëm tek punëdhënësi “B”, ka të drejtë që për efekt të vazhdimit të përfitimit të zbritjeve sipas paragrafit 1 të nenit 22, të dorëzojë deklaratën për statusin personal tek punëdhënësi “B”. Cdo përfitim i padrejtë i zbritjeve nga baza e tatimit përbën shkelje të legjislacionit tatimor dhe dënohet sipas parashikimeve në Ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”
5. Deklarata mbi statusin personal përfshin të gjitha informacionet e nevojshme për të pretenduar zbritje nga e ardhura e tatueshme sipas nenit 22 Paragrafi 1 “Zbritjet nga baza tatimore”.
6. Për përfitimin e zbritjeve sipas paragrafit gërmave “a”, “b” dhe “c” të paragrafit 1 të nenit 22, punëmarrësi duhet të depozitojë kontratën e punësimit ku është përcaktuar paga bruto e tij.
7. Për përfitimin e zbritjeve sipas gërmës “a”, të paragrafit 2 të nenit 22, punëmarrësi duhet të depozitojë kontratën me institucionin arsimor ku studiojnë fëmijët, si dhe transfertat apo pagesat bankare të kësteve të shkollimit.

8. Për përfitimin e zbritjeve sipas gjurmës “b”, të paragrafit 2 të nenit 22, punëmarrësi duhet të depozitojë dokumentacionin mjekësor, (recetën e leshuar nga mjeku/institucioni kompetent, faturën e pagesës së barnave).
9. Zbritjet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 22 “Zbritjet nga baza tatimore” aplikohen për:
 - a. Punëmarrësit, baza tatimore (paga bruto) e të cilëve reduktohet me këto zbritje
 - b. Personave fizikë të vetpunësuar dhe tregtarë me të ardhura nga biznesi, e ardhura neto e të cilëve reduktohet me këto zbritje.
10. Zbritjet e parashikuara në paragrafin 1 të nenit 22 “Zbritjet nga baza tatimore” nuk aplikohen mbi:
 - a. Pagën referuese për efekt të kontributeve të llogaritur nga personat fizikë tregtarë, të vetpunësuarit dhe;
 - b. Pagën referuese për efekt të kontributeve të personave të papaguar të familjes të punësuar tek personat fizikë tregtarë dhe tek të vetpunësuarit.
11. Formulari i Deklaratës mbi statusin personal që plotësohet nga punëmarrësi është sipas Modelit Nr..... bashkëngjitur këtij Udhëzimi.

67. Deklarata vjetore e të ardhurave personale

Personat që janë të detyruar të dorëzojnë Deklaratë vjetore të të ardhurave personale përfshijnë:

- a. Personat të cilët kanë realizuar të ardhura bruto nga punësimi më shumë se 1.200.000 lekë në një vit tatimor, pavarësisht nëse viti ka qënë i plotë apo jo i plotë.
- b. Personat, pavarësisht shumës së të ardhurave bruto vjetore nga punësimi, të cilët qoftë edhe për një muaj, kanë qënë të punësuar njëkohësisht në më tepër se një punëmarrës.
- c. Personat, të cilët kanë realizuar në një vit të plotë apo jo të plotë, më shumë se 50.000 lekë të ardhura të ndryshme nga të ardhurat nga punësimi, por për të cilat nuk është mbajtur tatimi në burim sipas përcaktimeve të Kapitullit 5 të Ligjit. Të ardhura të tilla mund të jenë:
 - Të ardhurat nga qeradhënia, kur qeramarrës është një individ i përgjithshëm si tatimpagues tregtar, i vetpunësuar apo entitet;
 - Të ardhura të realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nëse janë taksuar apo jo;
 - Të ardhura të tjera të cfarëdoforme, për të cilat paguesi nuk ka mbajtur ndonjë tatim në burim, megjithëse mund të ketë patur detyrimin ligjor për mbajtjen e tatimit në burim sipas përcaktimeve të Kapitullit 5 të Ligjit. Mosmbajtja e tatimit në burim nga paguesi i ndonjë të ardhure nuk e cliron personin përfitues nga përgjegjësia e mospagimit të detyrimit tatimor, pasi ai ka detyrimin për pagimin e tatimit, ndërkohë që paguesi i të ardhurës denohet sipas dispozitave për agjentin tatimor.
- d. Për qëllime deklarimi të Deklaratës vjetore të të ardhurave personale:

- Për personat rezidentë shqiptarë, Numri personal i kartës së identitetit/Numuri Unik i Identifikimit të Subjektit, shërben si numër i identifikimit tatimor.

Për personat jorezidentë shqiptarë, Numri personal i kartës së identitetit/Numuri Unik i Identifikimit të Subjektit, të lëshuara nga vendet ku këta persona janë rezidentë, shërben si numër i identifikimit tatimor në Shqipëri.

68. Deklarimi dhe pagesa nga entitete jorezidentë specifike

68.1 Neni 68 i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” përcakton deklaratë dhe procedurë pagesash të veçantë për jorezidentët, të cilët sipas nenit 27 të ligjit, janë subjekt i tatimit mbi fitimin, por për të cilët procedura e rregullt e parashikuar në nenet 61, dhe 63 nuk zbatohet.

68.2 Procedura e deklarimit sipas nenit 61 të ligjit, kërkon që tatimpaguesi të përgatisë pasqyrat financiare dhe deklaratën e fitimit të tatueshëm për aktivitetet që janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Dispozita e nenit 68 përfshin rastet kur një tatimpagues jorezident tatohet për transaksionet dhe veprimtaritë jashtë Shqipërisë, megjithëse nuk ka detyrimin për të përgatitur financiare dhe deklaratën tatimore sipas nenit 61. Në veçanti, ky mund të jetë një rast kur një person jorezident është subjekt i tatimit për një transaksion të izoluar të realizuar p.sh në një zonë “offshore”, si p.sh., shitja e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman të trajtuara në pikën 55të këtij udhëzimi në lidhje me pikën 5, të nenit 55.

68.3 Pika 1 e nenit 68 parashikon një deklarim të veçantë të të ardhurave të tatueshme për jorezidentët, ku një jorezident është objekt i nenit 27 të ligjit. Për qëllime deklarimi si më sipër do të përdoret deklarata e fitimit të tatueshëm sipas formularit “Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifike”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Pika 2 e nenit 68 përjashton këtë kategori nga sistemi i kësteve tatimore dhe sistemi i kreditimit të tatimit të huaj. Tatimi për këtë kategori deklarohet dhe paguhet në të njëjtën kohë kur paraqitet deklarata e tatim fitimit.

69. Lehtësitë tatimore